



# Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Qeveria-Vlada-Government*

*Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister*

*Zyra Ligjore - Zakonodavna Kancelarija - Legal Office*

---

## **Shtojca 2-Raporti për Thjeshtësimin e Lejimeve të Administruara nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve<sup>1</sup>**

**Mars 2023**

---

<sup>1</sup> Kjo analizë juridike është miratuar në Mbledhjen e 138-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 05/138 të datës 12.04.2023.

## Tabela e përmbatjes

<b>1. Hyrje.....</b>	<b>1</b>
<b>2. Baza ligjore dhe lista e lejimeve që administrohen nga MFPT .....</b>	<b>4</b>
<b>3. Të gjeturat kryesore dhe analiza ligjore .....</b>	<b>10</b>
<b>3.1. Parimi i ligjshmërisë .....</b>	<b>10</b>
<b>3.2. Pagesat dhe taksat .....</b>	<b>11</b>
<b>3.3. Aplikimi, shqyrtimi i lejimeve dhe zhvillimi i procedurës në mënyrë elektronike .....</b>	<b>11</b>
<b>4.1. Rekomandime të përgjithshme .....</b>	<b>22</b>
<b>4.2. Rekomandimet e veçanta .....</b>	<b>23</b>
<b>Shtojca 1 – Rekomandimet e veçanta .....</b>	<b>24</b>

## **Shkurtesat**

<b>KNF</b>	Korporata Ndërkombëtare Financiare
<b>MFPT</b>	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
<b>Lejim</b>	Njoftim, Regjistrim, Leje ose Licencë Profesionale
<b>LSLL</b>	Ligji për Sistemin e Lejeve dhe Licencave
<b>LPPA</b>	Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative
<b>Regjistri</b>	Regjistri i Lejeve dhe Licencave
<b>U.A.</b>	Udhëzim Administrativ
<b>KKRF</b>	Këshilli Kosovar për Raportim Financiar
<b>APRK</b>	Agjencinë e Punësimit e Republikës së Kosovës
<b>KMLVPP</b>	Këshilli Mbikëqyrës për Licencimin e Vlerësueseve të Pronave të Paluajtshme
<b>DPSF</b>	Departamentin e Politikave Sociale dhe Familjare

## 1. Hyrje

Projekti Klima e Investimeve II i Korporatës Ndërkombëtare Financiare (KNF)/pjesë e Grupit të Bankës Botërore, në kuadër të reformës për thjeshtësimin e lejeve dhe licencave në Republikën e Kosovës në koordinim me Zyren Ligjore të Zyrës së Kryeministrit, ka filluar analizën e inventarizimit dhe thjeshtësimin të lejimeve të administruara nga të gjitha ministritë duke përfshirë Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (këtu e tutje “MFPT”). Reforma për thjeshtësimin e sistemit të lejimeve është një ndër faktorët kyç për krijimin e një kornize për promovimin e cilësisë rregulluese, brenda një konteksti më të gjerë të përmirësimit të qeverisjes, duke përfshirë transparencën, llogaridhëniën dhe efikasitetin e shërbimit ndaj qytetarëve duke krijuar një medis më të përshatshëm afarist.

Mandatimi i reformës së sistemit të lejimeve në Kosovë ka filluar me aprovimin e Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave në vitin 2013 (këtu e tutje “LSLL”) (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8967>). Ky ligj vendos parimet dhe rregullat kryesore për krijimin e lejeve dhe licencave të reja si dhe për lejet dhe licencat ekzistuese. LSLL përcakton që lejet dhe licencat do të krijohen vetëm në rastet e domosdoshme për mbrojtjen e shëndetit publik, sigurisë publike, mjedisit dhe përdorimit të resurseve natyrore në Republikën e Kosovës, duke parandaluar kështu krijimin e barrierave administrative për biznese në rastet tjera. LSLL gjithashtu kërkon shqyrtimin e të gjitha lejeve dhe licencave ekzistuese për të konstatuar përputhshmërinë me këto parime dhe rregulla. Në bazë të LSLL është krijuar edhe Regjistri i Lejeve dhe Licencave (këtu e tutje “Regjistri”) në të cilin janë identifikuar lejimet që administrohen nga të gjitha organet e administratës shtetërore (<http://lejelicenca.rks-gov.net/>). Në harmoni me kërkesat ligjore të LSLL, këtë vit, Qeveria e Republikës së Kosovës ka hartuar një program për zvogëlimin e barrës administrative për të thjeshtësuar apo eliminuar procedurat dhe kërkesat që shkaktojnë shpenzime dhe humbje kohe për qytetarët e bizneset, që vlerësohen të panevojshme dhe që nuk mbrojnë interesin publik.

Sipas Shtojces 1, pikës 2.1. të Rregullores (QRK) - Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive<sup>2</sup>, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021<sup>3</sup> dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2022<sup>4</sup>, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtu e tutje “MFPT”) është përgjegjëse për “[p]ërgatitjen e politikave publike,

---

<sup>2</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=39317>

<sup>3</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=47884>

<sup>4</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=60962>

hartimin e akteve ligjore, hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore, si dhe përcaktimin e standardeve të detyrueshme në fushën e menaxhimit të financave publike, kontrollit të brendshëm dhe auditimit për sektorin publik, standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar për sektorin privat dhe ndërmarrjet publike, borxhit publik, prokurimin publik, politikave makro-ekonomike dhe fiskale, tatimit në pronë, ndihmës shtetërore, sigurisë dhe mbrojtjes në punë, marrëdhënies së punës, sigurisë dhe shëndetit në punë, dialogut social, punësimit, aftësimin profesional, politikave sociale, transfereve dhe pensioneve, duke i respektuar standardet e rëndësishme ndërkombëtare në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.”

Në kuadrin e përgjegjësive të saj, MFPT ndër të tjera administron një sërë lejimesh për aktivitete të ndryshme duke përfshirë: 1. Licenca për banderolla për prodhuesit e pijeve alkoolike, 2. Licenca për banderolla për importuesit e pijeve alkoolike, 3. Licenca për pagesën e taksës së akcizës për produkte të duhanit (apo Licencim (autorizim) për furnizim me banderola fiskale për produktet e duhanit), 4. Licencimi i auditorëve ligjor vendor, 5. Licencimi i auditorëve ligjor të huaj, 6. Licencimi i firmave ligjore vendore, 7. Licencimi i firmave ligjore të huaja (ndërmarrje auditore e huaj/jashtme), 8. Licencimi i shoqatave profesionale të kontabilitetit dhe auditimit, 9. Licencimi i vlerësuesve të pronave të paluajtshme (Shkalla I), 10. Licencimi i vlerësuesve të pronave të paluajtshme (Shkalla IA), 11. Licencimi i vlerësuesve të pronave të paluajtshme (Shkalla IAB), 12. Leje pune afatshkurtër për të huajt (deri në 90 ditë pune), 13. Regjistrimi i ofruesve jo-publik të shërbimeve të punësimit (Kategoria A, B, dhe C), 14. Leje për ofrues jo-publik të shërbimeve të punësimit (Kategoria D dhe E), 15. Licencimi i organizatave joqeveritare dhe subjekteve tjera juridike private që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare, 16. Licencimi i ofruesve individual të shërbimeve sociale dhe familjare, 17. Licencimi i personave juridik për ofrimin e shërbimeve për sigurinë dhe shëndetin në punë (Licenca e shërbimit), dhe 18. Licencimi i qendrave të trajnimit për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Ky raport ka për qëllim studimin dhe analizën e kornizës ligjore për lejimet e administruara dhe implemetimin e kësaj kornize në praktikë si dhe dhënien e rekomandimeve për thjeshtësimin e këtyre lejimeve në kuadër të MFPT-së.

Hartimi i këtij raporti është zhvilluar në 3 faza, si vijon:

*Faza e Parë:* Analiza preliminare ligjore e lejimeve që administrohen nga MFPT.

*Faza e Dytë:* Zhvillimi i takimeve me përfaqesues nga departamentet përkaëse të MFPT-së për mbledhjen e të dhënave dhe plotësimin e formularëve me informata të detajuara për secilin lejim.

*Faza e Tretë:* Shqyrtimi përfundimtar i informacionit të mbledhur dhe hartimi i raportit.

Gjatë fazës së parë, është bërë një analizë preliminare e legjislacionit relevant duke përfshirë Kodin Nr. 03/L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë, ligjet për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-021 për Akcizën në Produktet e Duhanit, për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, Tatimin në Pronën e Paluajtshme, të Huajt, Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt, Agjencinë e Punësimit Të Republikës Së Kosovës, Shërbime Sociale Dhe Familjare, Ndryshimin Dhe Plotësimin E Ligjit Nr. 02/L-17 Për Shërbime Sociale Dhe Familjare, Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe të gjitha Udhëzimet Administrative (këtu e tutje "U.A.") dhe rregulloret që rrjedhin nga këto akte ligjore, si dhe është analizuar përmbajtja e Regjstrit për lejjimet.

Gjatë fazës së dytë janë zhvilluar takime dhe konsultime me përfaqesues nga departamenti ligjor dhe departamentet tjera perkatese te MFPT-së për mbledhjen e të dhënave dhe plotësimin e formularëve me informata të detajuara për secilin lejjim.

Gjatë fazës së tretë janë verifikuar dhe analizuar të gjitha informatat e mbledhura me anë të formularëve kundrejt dispozitave ligjore përkatëse për secilin lejjim. Më tutje janë identifikuar mundësitë për thjeshtësim të këtyre lejjimeve që ka rezultuar me paraqitjen e tyre në formë të rekomandimeve për ndryshime dhe plotësime ligjore në këtë raport.

Struktura e raportit është organizuar në këtë mënyrë: në Kapitullin 2 të këtij raporti, është paraqitur kuadri kryesor ligjor që rregullon lejjimet që administrohen nga MFPT, nësa kapitulli 3 i dedikohet analizës së legjislacionit kryesor që rregullon lejjimet në Kosovë në përgjithësi dhe vendos parimet bazë të cilat janë të zbatueshme për lejjimet që administrohen nga MFPT në veçanti. Në këtë kapitull vëmendje e veçantë u kushtohet LSSL dhe LPPA që në mënyrë horizontale përcaktojnë parimet dhe rregullat për përmirësimin e mjedisit të të bërit biznes si dhe realizimin efektiv të autoritetit publik në shërbim të interesit publik, duke garantuar në të njëjtën kohë mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave juridike të personave. Në fund në Kapitullin 4, në bazë të analizës dhe gjetjeve sipas Kapitullit 2 dhe 3, janë paraqitur rekomandimet e përgjithshme, dhe ato veçanta të cilat janë shtjelluar në mënyrë të detajuar në Shtojcën 1 të këtij raporti.

## 2. Baza ligjore dhe lista e lejimeve që administrohen nga MFPT

Sic është theksuar më lartë, dhënia dhe administrimi i lejimeve në kuadër të MFPT-së përcaktohen me anë të një sërë ligjesh, duke përfshirë Kodin Nr. 03/L-109 Doganor dhe të Akcizave në Kosovë (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2600>) (këtu e tutje “Kodi Doganor dhe i Akcizave”), Ligjin Nr. 08/L-115 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-021 për Akcizën në Produktet e Duhanit (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=60329>) (këtu e tutje “Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Akcizën në Produktet e Duhanit, Ligjin Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=16268>) (këtu e tutje “Ligji për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim”), Ligji Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15984>) (këtu e tutje “Ligji për Tatimin në Pronën e Paluajtshme”), Ligjin Nr. 04/L-219 për të Huajt (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8876>) (këtu e tutje “Ligji për të Huajt”), Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për të Huajt (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8876>) (këtu e tutje “Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për të Huajt”), Ligji Nr. 04/L-205 për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8983>) këtu e tutje “Ligji për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës”), Ligjin Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2447>) (këtu e tutje “Ligji Për Shërbime Sociale Dhe Familjare”), Ligji Nr. 04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-17 Për Shërbime Sociale Dhe Familjare (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2447>) (këtu e tutje “Ligji Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare”), Ligjin Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8689>) (këtu e tutje “Ligji Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”).

Aspekte të ndryshme të rregullimit të lejimeve si shqyrtimi i kërkesave, vlefshmëria e lejeve/licencave, dhënia, ri-përtëritja apo pezullimi i lejeve/licencave, si dhe procedurat e ankesës, tarifatat etj., përcaktohen me anë të akteve nënligjore si në vijim: a) Për Licencën për banderolla për prodhuesit e pijeve alkoolike, Licencën për banderolla për importuesit e pijeve alkoolike, Udhëzimi Administrativ 86/2010 që përcakton obligimin e vendosjes së shenjave kontrolluese fiskale banderolave në pijet alkoolike (<https://dogana.rks-gov.net/wp-content/uploads/2010/10/86-UA-Qe-percakton-obligimin-e-vendosjes-se-shenjave-kontrolluese-fiskale-banderolavene-pijet-alkoolike-440019.pdf>) dhe Udhëzimi Administrativ 44/2017 për ndryshimin dhe plotësimin e U.A. Nr. 86/2010 që përcakton obligimin e vendosjes së shenjave kontrolluese fiskale në pijet alkoolike (<https://dogana.rks-gov.net/wp-content/uploads/2016/11/101e.UA.per.ndryshimin.dhe.plotesimin.e.UA.nr.86e2010.qe.percakt>

[on.obligimin.e.vendosjes.se.shenjave.kontrolluese.fiskale.971202.pdf](https://on.obligimin.e.vendosjes.se.shenjave.kontrolluese.fiskale.971202.pdf)), b) Për Licencën për pagesën e taksës së akcizës për produkte të duhanit (apo autorizim) për furnizim me banderola fiskale për produktet e duhanit), Udhëzimi Administrativ Nr. 4/2012 për lëshimin e licencës për pagesën e taksës së akcizës dhe shumës së taksës administrative (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8194>), c) Për Licencimin e auditorëve ligjor vendor, Licencimin e auditorëve ligjor të huaj, Licencimin e firmave ligjore vendore, Licencimin e firmave ligjore të huaja (ndërmarrje auditore e huaj/jashtme), Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2019 (MFPT) për licencimin e auditorëve ligjor dhe firmave vendore e të huaja ligjore të auditimit (<https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/C4F85DE6-4BAE-4110-9618-9043A67EA16C.pdf>), d) Për Licencimin e shoqatave profesionale të kontabilitetit dhe auditimit, Udhëzimi Administrati Nr. 01/2014 mbi kriteret për njohjen e shoqatave profesionale të kontabilitetit/auditimit (<https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/8FF41AEA-7B05-4348-8B65-65824DB5F45D.pdf>), e) Për Licencimin e vlerësuesve të pronave të paluajtshme (Shkalla I), Licencimin e vlerësuesve të pronave të paluajtshme (Shkalla IA) dhe Licencimin e vlerësuesve të pronave të paluajtshme (Shkalla IA), Rregullorja Nr. 06 e Bordit Mbikqyrës për Procedurat dhe Kriteret e Licencimit të Personave Fizik si Vlerësues të Pronave të Paluajtshme (2013) e cila nga MFPT konsiderohet e shfuqizuar dhe nuk gjindet online, ndërsa draft-rregullorja të cilën e ka hartuar Keshilli Mbikqyres per Licencimin e Vlerësuesve të Pronave të Paluajtshme (këtu e tutje “KMLVPP”), ende nuk është miratuar, pasi që aktualisht është në procedure miratimi, f) Për Leje punë afatshkurtër për të huajt (deri ne 90 ditë pune), Udhëzimi Administrativ (Mpb) Nr. 09/2019 për Procedurën dhe Kriteret e Lëshimit të Lejes së qëndrimit për të Huajt (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=23314>).

Në bazë të nenit 5 të LSSL përcaktohen 4 kategori të Lejimeve në 1) njoftim, 2) regjistrim, 3) leje, dhe 4) licencë profesionale “të listuara në renditje proporcionale me nivelin e rrezikut të cilin secili lloj është i projektuar të adresojë, nga rreziku më i ultë për shëndetin publik, sigurinë publike ose mjedisin ose ndikimin më të ultë në përdorimin e resurseve natyrore deri te rreziku apo ndikimi më i lartë.” Në bazë të analizës së lejimeve të vendosura në Regjister dhe pas analizës së akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse rezulton se në Regjister si lejime janë të vendosura 12 autorizime duke përfshirë Autorizimin për Tregtar të Mallërave Akcizor, Autorizimin për procedurë të thjeshtëzuar, Autorizimin për përpunim të jashtëm, Autorizimin për lirim nga taksa akcizës për Vajrat e rënda për ngrohje (Mazut), Autorizimin për drejtues të depos së mallrave akcizor, Autorizim për depo të mallrave akcizor, Autorizimin për përpunim nën kontroll doganor, Autorizim për lirim në qarkullim të lirë, Autorizimin për Përpunim të Brendshëm, Autorizim për Depo Doganore, Autorizim për lirim nga taksa e akcizës - propan gas, Autorizimin për lirim nga taksa e akcizës për mallin (Naftë). Prandaj meqenëse këto nuk janë lejime në kuptimin e LSSL, këto autorizime duhet të hiqen nga Regjistri. Poashtu, në Regjister janë të vendosura edhe 6 lejime që nuk janë në fuqi për shkak të shfuqizimit të Ligji Nr. 04/L – 080 për Lojërat e Fatit dhe si rrjedhojë këto lejime duhet të largohen nga Regjistri.



Nga analiza e akteve ligjore dhe nën-ligjore si dhe verifikimit të të dhënave të mbedhura nga zyrtarët e MFPT rezulton që MFPT administron 18 lejime, 15 nga këto hyjnë në kategorinë e licencave, 3 në kategorinë e lejeve, 1 në kategorinë e regjistrimeve. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat bazike për secilin lejim të administruar nga MFPT.

**Tabela Nr.1. Lejimet e administruara nga MFPT**

<b>Ministria e Financave, Punës dhe</b>			
<b>Transfereve</b>			
<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Lloji i lejit (sipas LSSL)</b>	<b>Aktet Juridike</b>
MFPT-1	Licenca për banderolla për prodhuesit e pijeve alkoolike	Licencë	Kodi Nr. 03/L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë  Udhezim Administrativ 86/2010 që përcakton obligimin e vendosjes së shenjave kontrolluese fiskale banderolavene pijet alkoolike  Udhezim Administrativ 44/2017 për ndryshimin dhe plotësimin e U.A. Nr. 86/2010 që përcakton obligimin e vendosjes së shenjave kontrolluese fiskale në pijet alkoolike
MFPT-2	Licenca për banderolla për importuesit e pijeve alkoolike	Licencë	Kodi Nr. 03/L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë  Udhezim Administrativ 44/2017 për ndryshimin dhe plotësimin e U.A. Nr. 86/2010 që përcakton obligimin e vendosjes së shenjave kontrolluese fiskale në pijet alkoolike
MFPT-3	Licenca për pagesën e taksës së akcizës për produkte të duhanit (apo Licencim	Licencë	Ligji Nr. 08/L-115 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-021 për Akcizën në Produktet E Duhanit

	(autorizim) për furnizim me banderola fiskale për produktet e duhanit)		Udhëzim Administrativ Nr. 3/2012 për lëshimin e licencës për pagesën e takses së akcizes dhe shumës së takses administrative
MFPT-4	Licencimi i auditorëve ligjor vendor	Licencë	Ligjit Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim  Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2019 (MFPT) për licencimin e auditorëve ligjor dhe firmave vendore e të huaja ligjore të auditimit
MFPT-5	Licencimi i auditorëve ligjore të huaj	Licencë	Ligjit Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim  Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2019 (MFPT) për licencimin e auditorëve ligjor dhe firmave vendore e të huaja ligjore të auditimit
MFPT-6	Licencimi i firmave ligjore vendore	Licencë	Ligjit Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim  Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2019 (MFPT) për licencimin e auditorëve ligjor dhe firmave vendore e të huaja ligjore të auditimit
MFPT-7	Licencimi i firmave ligjore të huaja (ndërmarrje auditore e huaj/jashtme)	Licencë	Ligjit Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim  Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2019 (MFPT) për licencimin e auditorëve ligjor dhe firmave vendore e të huaja ligjore të auditimit
MFPT-8	Licencimi i shoqatave profesionale të kontabilitetit dhe auditimit	Licencë	Ligjit Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim  Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2014 mbi kriteret për njohjen e shoqatave profesionale të kontabilitetit/auditimit

MFPT-9	Licencimi i vlerësuesve të pronave të paluajtshme (Shkalla I)	Licencë	Ligji Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme  Rregullorja Nr. 06 e Bordit Mbikqyrës për Procedurat dhe Kriteret e Licencimit të Personave Fizik si Vlerësues të Pronave të Paluajtshme (2013)
MFPT-10	Licencimi i vlerësuesve të pronave të paluajtshme (Shkalla IA)	Licencë	Ligji Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme  Rregullorja Nr. 06 e Bordit Mbikqyrës për Procedurat dhe Kriteret e Licencimit të Personave Fizik si Vlerësues të Pronave të Paluajtshme (2013)
MFPT-11	Licencimi i vlerësuesve të pronave të paluajtshme (Shkalla IAB)	Licencë	Ligji Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme  Rregullorja Nr. 06 e Bordit Mbikqyrës për Procedurat dhe Kriteret e Licencimit të Personave Fizik si Vlerësues të Pronave të Paluajtshme (2013)
MFPT-12	Leje pune afatshkurtër për të huajt (deri në 90 ditë pune)	Leje	Ligji Nr. 04/L-219 për të Huajt  Ligji Nr. 06/L -036 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt  Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 09/2019 për Procedurën dhe Kriteret e Lëshimit të Lejes së Qëndrimit për të Huajt
MFPT-13	Regjistrimi i ofruesve jo-publik të shërbimeve të punësimit (Kategoria A, B, dhe C)	Regjistrim	Udhëzimi Administrativ( MPMS) Nr. 03/2015 për Licencimin e Ofruesve Jo-Publik të Shërbimeve të Punësimit
MFPT-14	Leje për ofrues jo-publik të shërbimeve të punësimit	Leje	Ligji Nr. 04/L-205 Për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës

	(Kategoria D dhe E)		Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr. 03/2015 për licencimin e ofruesve jo-publik të shërbimeve të punësimit
MFPT-15	Licencimi i organizatave joqeveritare dhe subjekteve tjera juridike private që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare	Licencë	Ligji Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare Ligji Nr. 04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr. 02/2020 për Licencimin e Organizatave Jo Qeveritare dhe Subjekteve Juridike Private që Ofrojnë Shërbime Sociale dhe Familjare
MFPT-16	Licencimi i ofruesve individual të shërbimeve sociale dhe familjare	Licencë	Ligji Nr. 04/L-081 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale Dhe Familjare Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr. 02/2020 për Licencimin e Organizatave Jo Qeveritare dhe Subjekteve Juridike Private që Ofrojnë Shërbime Sociale dhe Familjare
MFPT-17	Licencimi i personave juridik për ofrimin e shërbimeve për sigurinë dhe shëndetin në punë (Licenca e shërbimit)	Licencë	Ligji Nr. 04/L-161 Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë Rregullore (MPMS) Nr. 01/2021 për Kualifikimin e Personave Përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Licencimin e Kompanive të Shërbimeve dhe Trajnimeve për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë
MFPT-18	Licencimi i qendrave të trajnimit për sigurinë dhe shëndetin në punë	Licencë	Ligji Nr. 04/L-161 Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë Rregullore (MPMS) Nr. 01/2021 për Kualifikimin e Personave Përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Licencimin e Kompanive të Shërbimeve dhe Trajnimeve për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë

### 3. Të gjeturat kryesore dhe analiza ligjore

Kjo pjesë e raportit i dedikohet analizës së legjislacionit kryesor që rregullon lejitimet në Kosovë në përgjithësi dhe vendos parimet bazë të cilat janë të zbatueshme për lejitimet që administrohen nga MFPT në veçanti. LSSL është ligj i përgjithshëm me efekt horizontal që përcakton parimet dhe rregullat për përmirësimin e mjedisit të të bërit biznes nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative si dhe të zhvillimit të veprimtarive ekonomike, tregtare apo profesionale, që është e domosdoshme për të mbrojtur shëndetin publik, sigurinë publike, mjedisin dhe përdorimin e resurseve natyrore në Republikën e Kosovës<sup>5</sup>. Ligj tjetër i përgjithshëm me efekt horizontal për të gjitha lejitimet që rregullon në përgjithësi ushtrimin e autoritetit publik nga organet shtetore qendrore dhe lokale është Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (këtu e tuje “LPPA”), qëllimi i të cilit është që të sigurojë realizimin efektiv të autoritetit publik në fregjisshërbim të interesit publik, duke garantuar në të njëjtën kohë mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave juridike të personave.<sup>6</sup> Më poshtë do të analizohen disa nga parimet dhe rregullat kryesore të parashikuara në këto ligje dhe ndërlidhshmëria e tyre me rregullat e veçanta egzistuese në legjislacionin që rregullon lejitimet e administruara nga MFPT.

#### 3.1. Parimi i ligjshmërisë

Parimi i ligjshmërisë, në rastin konkret, ka të bëjë me domosdoshmërinë e të qenit në përputhje me ligjin të një akti tjetër ligjor. Ky parim përcaktohet si kërkesë dhe obligim ligjor në LSSL, LPPA, si dhe në Kushtetutën e Kosovës. Nga interpretimi i këtyre dispozitave e posaçërisht nenit 17 të LSSL, përcaktimi i lejeve dhe licencave duhet të parashihet vetëm me ligj. Baza ligjore për lejitimet e administruara nga MFPT është e përcaktuar në mënyrë të qartë për të gjitha lejitimet. Në mungesë të përcaktimit të bazës ligjore apo kategorizimit të qartë me anë të ligjeve disa lejitime parashihen ose kategorizohen me anë të akteve nënligjore sic janë Licencimi i vlerësuesve të pronave të paluajtshme (Shkalla I), Licencimi i vlerësuesve të pronave të paluajtshme (Shkalla IA), Licencimi i vlerësuesve të pronave të paluajtshme (Shkalla IAB) dhe Regjistrimi i ofruesve jo-publik të shërbimeve të punësimit (Kategoria A, B, dhe C).

<sup>5</sup> Neni 1, Ligji Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave

<sup>6</sup> Neni 1, Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative

Ky rregullim nuk është në pajtuesmeri me nenin 17 të LSSL i cili parasheh që lejimet mund të përcaktohen vetëm me anë të ligjit.

### 3.2. Pagesat dhe taksat

Nga analiza e këtyre tarifave vërehet se vendosja e tyre është bërë pa ndonjë kriter të qartë që është në kundërshtim me parimin e vendosjes së tarifës në bazë të shpenzimit të procedurës së organit publik. Siç është cekur më lartë, ky kriter është i përcaktuar në nenin 18 të LSSL, paragrafin 2 të nenit 12 të LPPA. Rrjedhimisht, është i nevojshëm rishikimi këtyre tarifave dhe nëse nuk janë caktuar sipas këtij parimi, të zëvendësohen me nivelet e tarifave të llogaritura në bazë të këtij parimi.

### 3.3. Aplikimi, shqyrtimi i lejimeve dhe zhvillimi i procedurës në mënyrë elektronike

Aplikimi dhe zhvillimi i procedurës në mënyrë elektronike është një tjetër aspekt i cili ndikon drejtpërsëdrejti në të drejtat e personave për t'u pajisur me një leje apo licencë. Aplikimi elektronik është kërkesë ligjore e LSSL, ndërsa zhvillimi i procedurës në mënyrë elektronike kërkesë e LPPA. Në rastin konkret MFPT nuk ka një sistem elektronik për qëllim të aplikimit dhe zhvillimit të procedurës së shqyrtimit për lejimet e administruara. Kjo çështje pritet të adresohet me anë të programit qeveritar për zvogëlimin e barrës administrative.

#### Licenca për banderolla për prodhuesit e pijeve alkoolike

Përmes kësaj procedure mundësohet licencimi i prodhuesve të pijeve alkoolike për furnizim me shenjat kontrolluese fiskale (banderolla). Procedura fillon me dorëzimin e formularit sipas Shtojcës A/1 të Udhëzimit Administrativ 44/2017 për ndryshimin dhe plotësimin e U.A. Nr. 86/2010 që përcakton obligimin e vendosjes së shenjave kontrolluese fiskale në pijet alkoolike. Në kuadër të dokumenteve për licencim, sipas nenit 5A, kërkohen aplikacioni, formulari, kërkesa, dokumentet e raportimit, varësisht nga lloji i pijes alkoolike që importohet, kopja e certifikatës së biznesit dhe numrit fiskal si dhe kodet ekonomike dhe shifrat e veprimtarisë për të cilën është regjistruar. Afati për shqyrtimin e kërkesës për licencë nuk është paraparë me U.A., dhe në mungesë të kësaj vlen afati prej 45 ditë i vendosur sipas nenit 98 të LPPA. U.A. nuk rregullon aspektet tjera ankesën, pezullimin, ndërprerjen e licencës, validitetin e licences, tarifën etj. Për

vazhdimin e licencës zbatohen rregullat dhe kriteret e njejta për marrjen e licencës fillestare. Lëshimi i kësaj licence është i afatizuar dhe kjo nuk është praktikë e mirë dhe paraqet hapësirë për thjeshtësim në mënyrë që vlefshmëria e licences të jetë pa afat. Licenca lëshohet e nënshkruar nga Drejtori Gjeneral i Doganës së Kosovës.

#### Licenca për banderolla për importuesit e pijeve alkoolike

Përmes kesaj procedure mundësohet licencimi i importuesve të pijeve alkoolike për furnizim me shenjat kontrolluese fiskale (banderolla). Aplikuesit paraqesin kërkesen për licencim fillimisht duke dorëzuar aplikacionin e plotësuar si dhe dokumentacionin e nevojshëm tek sektori i pcedurave doganore dhe autorizimeve të Doganës së Kosovës. Më pas kërkesa shqyrtohet nga Komisioni për licencim. Kërkesa për këtë licencë dorëzohet me anë të formularit A/1 që gjindet në Shtojcen 1 të U.A. Nr. 44/2017 dhe për kohën e vendimit vlen afati prej 45 ditësh sipas nenit 98 të LPPA. Në kuadër të dokumenteve për licencim, sipas nenit 5A, kërkohet të dorëzohen aplikacioni, formulari, kërkesa, dokumentet e raportimit, varësisht nga lloji i pijes aloolike që importohet, kopja e certifikates së biznesit dhe numrit fiskal si dhe kodet ekonomike dhe shifrat e veprimtarisë për të cilën është regjistruar. Në mungesë të dispozitave që rregullojnë ankesën, zbatohen dispozitat relevante të LPPA. Licenca lëshohet e nënshkruar nga Drejtori Gjeneral i Doganës së Kosovës. Për vazhdimin e licencës zbatohen rregullat dhe kriteret e njejta për marrjen e licencës fillestare. Lëshimi i kësaj licence është i afatizuar dhe kjo nuk është praktikë e mirë dhe si rrjedhojë këtu ka hapësirë për thjeshtësim në mënyrë që vlefshmëria e licencës të jetë pa afat.

#### Licenca për pagesën e taksës së akcizës për produkte të duhanit (autorizim) për furnizim me banderola fiskale për produktet e duhanit)

Përmes kësaj procedure mundësohet lëshimi i licences për pagesën e taksës së akcizës që duhen ta kenë të gjithë subjektet që merren me importin, eksportin, dhe prodhimin e produkteve të duhanit në Kosovë. Tatimpaguesit e akcizës janë të detyruar që më pas të aplikojnë për banderola fiskale në Doganë për porosinë e banderolave fiskale. Banderola nënkupton pullën fiskale që i ngjitet çdo njësie të zakonshme të produkteve të duhanit, si dëshmi e pagesës së akcizës. Kërkesa për licencë dorëzohet në bazë të formularit që gjindet në Shtojcen 1 të Udhëzimit Administrativ Nr. 4/2012 për lëshimin e licencës për pagesën e taksës së akcizës dhe shumës së taksës administrative. Si pjesë e dokumentacionit, sipas nenit 4 të U.A., në mes tjerash kërkohen edhe certifikata e regjistrimit të biznesit, certifikata e tatimpaguesit -TVSH, certifikata e numrit fiskal, kontrata me prodhuesin për furnizim me cigare dhe i lihet Doganës në diskrecion që të kërkojë edhe dokumente shtesë pa e specifikuar cilat janë ato. Ky dokumentacion kërkohet që të dorëzohet në kopje origjinale apo të vërtetuara – dhe këtu ka nevojë për thjeshtësim në mënyrë që palëve t’u kerkohen vetem kopje. Sipas nenit 5 paragrafi 4 licenca lëshohet me afat për një vit. Njëkohësisht, tarifa prej 100 euro, sipas nenit 6 nuk duket të jetë e llogaritur në bazë të parimit të shpenzimit të procedurës së organit kompetent, prandaj është e nevojshme që kjo tarifë të analizohet dhe sipas nevojës të llogaritet dhe përcaktohet në bazë të këtij parimi. Licenca lëshohet e nënshkruar nga Drejtori Gjeneral i Doganës. Për ri-licencim zbatohen rregullat dhe

kriteret e njejta për marrjen e licencës fillestare. Lëshimi i kësaj licence në afat prej 1 viti nuk është praktikë e mirë dhe këtu ka hapësirë për thjeshtësim në mënyrë që vlefshmëria e licencës të jetë pa afat.

#### Licencimi i auditorëve ligjor vendor

Përmes kësaj procedure mundësohet licencimi i auditorëve ligjor vendor (të brendshëm). Para se të aplikojnë për pajisje me licencë, auditorët/aplikuesit duhet të marrin pjesë në arsim profesional dhe të kenë kaluar provimet e parapara me Ligj, të kenë marrë pjesë në arsimin profesional dhe të kenë kaluar provimet për auditorë, të kenë tri (3) vite përvojë punë nën mbikëqyrjen e një auditori ligjor ose të një firme të auditimit, si dhe të jenë anëtar të një shoqate në Kosovë. Aplikuesit paraqesin kërkesen për licencim fillimisht duke dorëzuar aplikacionin e plotësuar si dhe dokumentacionin e nevojshëm tek sekretariati i KKRF, i cili bën shqyrtimin e dokumentacionit dhe kompletimin e lëndes. Me pas lënda shqyrtohet nga Komisioni për licencim (i përberë nga 3 anëtarë), dhe vendimi për lëshimin e licencës aprovohet/refuzohet nga KKRF-me shumicë votash (i përbërë prej 7 anëtarë). Licenca lëshohet e nënshkruar nga Kryesuesi i Keshillit për afat kohorë njevjeçar, pas së cilit aplikuesi duhet të aplikojë për vazhdim të licencës. Lëshimi i kësaj licence në afat prej 1 viti nuk është praktikë e mirë dhe këtu ka hapësirë për thjeshtësim në mënyrë që vlefshmëria e licencës të jetë pa afat. Në këtë procedurë kërkesa dorezohet me anë të formularit të publikuar në webfaqen zyrtare të MFPT (draftuar nga zyrtaret konform UA-së) përmes të cilit kërkohen një sërë dokumentesh duke përfshirë certifikatën e biznesit, certifikatën e nr. fiskal, certifikatën e auditorit nga Shoqata Profesionale, dëshminë e anëtarisë në Shoqatën Profesionale, dëshmi –vertetim për përvojë tre (3) vjeçare në auditim me orar të plotë, dëshmi –vertetim për punë në mbikëqyrje të auditorit ligjor, letër referencë, formulari për caktimin e punëdhësit për lajmërim në ATK ose pasqyrat vjetore nga TRUSTI, policën e sigurimit, letër angazhime ose kontrata për bashkëauditim në subjekte të auditimit etj. I gjithë ky dokumentacion kërkohet të dorëzohen në origjinal ose të noterizuara që paraqet mundësi për thjeshtësim. Kundër vendimit mbi kërkesen për licencë mund të ushtrohet ankesë sipas dispozitave relevante të LPPA. Tarifa për licencim është 300 euro, sipas Vendimit të KKRF-së për taksa administrative, pika 2, i datës 03 Maj 2013 ndërsa tarifa për aplikim është 30 euro sipas Vendimit të KKRF-së për taksa administrative, pika 1, Dt. 03 Maj 2013 (i publikuar në webfaqe). Licenca lëshohet e nënshkruar nga Kryesuesi i KKRF-së.

#### Licencimi i auditorëve ligjorë të huaj

Përmes kësaj procedure mundësohet licencimi i auditorëve ligjorë të huaj. Para se të aplikojnë për pajisje me licencë, auditorët/aplikuesit (si ata vendor ashtu edhe ata të huaj) duhet të marrin pjesë në arsim profesional dhe të kenë kaluar provimet e parapara me Ligj, të kenë tri (3) vite përvojë pune nën mbikëqyrjen e një auditori ligjor ose të një firme të auditimit, si dhe të jenë anëtar të një shoqate në Kosovë. Aplikuesit paraqesin kërkesen për licencim fillimisht duke dorëzuar aplikacionin e plotësuar si dhe dokumentacionin e nevojshëm tek sekretariati i KKRF, i cili bën shqyrtimin e dokumentacionit dhe kompletimin e lëndes. Me pas kërkesa shqyrtohet nga



Komisioni për licencim (i përbërë nga 3 anëtarë), dhe vendimi për lëshimin e licencës aprovet/refuzohet nga KKRF- me shumicë votash (i përbërë prej 7 anëtarë). Licenca lëshohet e nënshkruar nga Kryesuesi i Këshillit për afat kohor njëvjeçar, pas se cilit aplikuesi duhet të aplikojë për vazhdim të licencës. Afati për shqyrtim të kërkeses dhe procedura e ankeses në vendim nuk janë të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2019 (MFPT) për licencimin e auditorive ligjore dhe firmave vendore të huaja ligjore të auditimit dhe në këtë rast zbatohen dispozitat e LPPA. Sipas U.A. dhe formularit të publikuar në webfaqe të MFPT në kuadër të dokuemntacionit kërkohen certifikata e biznesit, certifikata e nr.fiskal, licencë profesioni nga organizata anëtare e IFAC-FNK , marrëveshja për njohje reciproke mes organizatës që e ka lëshuar licencën dhe FNK-IFAC, dëshmi për dhënien e provimeve për ligjet komerciale, të punës dhe tatimeve të Republikës së Kosovës në një Shoqatë Profesionale, dëshmi e anëtarësisë në Shoqatën Profesionale, letër reference nga tre (3) auditor të jashtëm si dëshmi për standardet e larta të kompetencës dhe integritetit profesional të aplikuesit, deklarata me shkrim nga aplikuesi se nuk është denuar ndonjëher për mashtrim ose parregullësi financiare në vendin ku e ka marr certifikatën–licencen për ushtrimin e profesionit, policën e sigurimit, dëshmi për taksat e paguara sipas tarifës së caktuar nga KKRF dhe dëshmi së është banor rezident në Kosovë. Kërkohe që dokumentet e paraqitura duhet të jenë në origjinal ose të noterizuara, prandaj këtu ka hapësirë për thjeshtësim. Tarifa për licencim është 750 euro, Vendimi I KKRF-së për taksa administrative, pika 3, Dt. 03 Maj 2013 dhe tarifa për aplikim 30 euro, Vendimi I KKRF-së për taksa administrative, pika 1, Dt. 03 Maj 2013 (i publikuar ne webfaqe) dhe kjo përbën mundësi për thjeshtësim. Validiteti i licenes është 1 vjet dhe lëshimi i kësaj licence në afat prej 1 viti nuk është praktikë e mirë dhe këtu ka hapësirë për thjeshtësim në mënyrë që vlefshmëria e licencës të jetë pa afat.

#### Licencimi i firmave ligjore vendore (ndërmarrje vendore e auditimit)

Përmes kësaj procedure mundësohet licencimi i firmave ligjore vendore. Aplikuesit të cilët plotësojnë kushtet për licencim të parapara në Nenin 7 paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2019 (MFPT) për licencimin e auditorive ligjore dhe firmave vendore të huaja ligjore të auditimit), paraqesin kërkesën për licencim fillimisht duke dorëzuar aplikacionin e plotësuar si dhe dokumentacionin e nevojshem tek sekretariati i KKRF, i cili bën shqyrtimin e dokumentacionit dhe kompletimin e lëndes. Më pas lenda shqyrtohet nga Komisioni për licencim (i përbërë nga 3 anëtarë), dhe vendimi për lëshimin e licencës aprovet/refuzohet nga KKRF- me shumicë votash (i përbërë prej 7 anëtarë). Afati për shqyrtim të kërkesës dhe procedura e ankesës në vendim nuk janë të përcaktuara me këtë U.A. dhe në këtë rast zbatohen dispozitat e LPPA. Sipas U.A. dhe formularit të publikuar në webfaqe të MFPT në kuadër të dokuemntacionit kërkohen certifikata e biznesit, certifikata e nr. fiskal, dëshmi për anëtarësinë e auditorëve në Shoqatën Profesionale. Kërkohe që dokumentet e paraqitura duhet të jenë në origjinal ose të noterizuara, prandaj këtu ka hapësirë për thjeshtësim. Tarifa për licencim është 1500 euro, Vendimi I KKRF-së për taksa administrative, pika 4, Dt. 03 Maj 2013 dhe tarifa për aplikim 30 euro, Vendimi i KKRF-së për taksa administrative, pika 1, Dt. 03 Maj 2013 (i publikuar në webfaqe) dhe këtu ka hapësirë për thjeshtësim dhe rilogaritje të këtyre tarifave në bazë të parimit të shpenzimit të procedurës administrative. Licenca lëshohet e nënshkruar nga Kryesuesi i Këshillit për afat kohor njëvjeçar. Lëshimi i kësaj licence në afat prej 1 viti nuk është praktikë e mirë dhe këtu ka hapësirë për thjeshtësim në mënyrë që vlefshmëria e licencës të jetë pa afat.

### Licencimi i firmave ligjore të huaja (ndërmarrje auditore e huaj/jashtme)

Përmes kësaj procedure mundësohet licencimi i firmave ligjore të huaja (të jashtme). Aplikuesit të cilët plotësojnë kushtet për licencim të parapara në Nenin 11 paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2019 (MFPT) për licencimin e auditorive ligjore dhe firmave vendore të huaja ligjore të auditimit), paraqesin kërkesën për licencim fillimisht duke dorëzuar aplikacionin e plotësuar si dhe dokumentacionin e nevojshëm tek sekretariati i KKRF, i cili bën shqyrtimin e dokumentacionit dhe kompletimin e lëndës. Më pas lënda shqyrtohet nga Komisioni për licencim (i përbërë nga 3 anëtarë), dhe vendimi për lëshimin e licencës aprovohet/refuzohet nga KKRF-me shumicë votash (i përbërë prej 7 anëtarë). Afati për shqyrtim të kërkesës dhe procedura e ankesës në vendim nuk janë të përcaktuara me këtë U.A. dhe në këtë rast zbatohen dispozitat e LPPA. Sipas U.A. dhe formularit të publikuar në webfaqe të MFPT në kuadër të dokumentacionit kërkohej certifikata e biznesit, certifikata e nr. fiskal, Licencë Profesionale nga organizata anëtare e IFAC-FNK, marrëveshja për njohje reciproke mes organizatës që e ka lëshuar licencën dhe FNK-IFAC, dëshmi për dhënien e provimeve për ligjet komerciale, të punës dhe tatimeve të Republikës së Kosovës në një Shoqatë Profesionale, dëshmi e anëtarësisë në Shoqatën Profesionale, letër referencë nga tre (3) auditor të jashtëm si dëshmi për standardet e larta të kompetencës dhe integritetit profesional të aplikuesit, deklarata me shkrim nga aplikuesi se nuk është dënuar ndonjëherë për mashtrim ose parregullësi financiare në vendin ku e ka marrë certifikatën – licencën për ushtrimin e profesionit, polica e sigurimit etj. Kërkohej që dokumentet e paraqitura të jenë në origjinal ose të noterizuara, prandaj këtu ka hapësirë për thjeshtësim. Tarifa për licencim është 3000 euro, Vendimi I KKRF-së për taksa administrative, pika 4, Dt. 03 Maj 2013 dhe tarifa për aplikim 30 euro, Vendimi I KKRF-së për taksa administrative, pika 1, Dt. 03 Maj 2013 (i publikuar në webfaqe) dhe këtu ka hapësirë për thjeshtësim duke llogaritur këto tarifa në bazë të parimit të shpenzimit të procedurës administrative. Licenca lëshohet e nënshkruar nga Kryesuesi i KKRF-së për afat kohor njëvjeçar. Lëshimi i kësaj licence në afat prej 1 viti nuk është praktikë e mirë dhe këtu ka hapësirë për thjeshtësim në mënyrë që vlefshmëria e licencës të jetë pa afat

### Licencimi i shoqatave profesionale të kontabilitetit dhe auditimit

Përmes kësaj procedure mundësohet licencimi i shoqatave profesionale të kontabilitetit dhe auditimit. Shoqatat të cilat plotësojnë kushtet për licencim të parapara në Nenin 33 të Ligjit Nr. 06/L-032 dhe nenin 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2014 mbi kriteret për njohjen e shoqatave profesionale të kontabilitetit/auditimit, paraqesin kërkesën për licencim fillimisht duke dorëzuar aplikacionin e plotësuar si dhe dokumentacionin e nevojshëm tek sekretariati i KKRF, i cili bën shqyrtimin e dokumentacionit dhe kompletimin e lëndës. Në kuadër të dokumentacionit, në mes tjerash, kërkohej edhe statuti, strategjia dhe plani i biznesit, burimet financiare, të jete organizate joqeveritare sipas Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Jo Qeveritare etj. Nuk është e përcaktuar qartë në U.A. nëse dokumentacioni kërkohej të dorëzohet në origjinal apo kopje dhe në këtë rast ka hapësirë për thjeshtësim duke mundësuar dorëzimin e këtyre dokumenteve në kopje. Më pas kërkesa shqyrtohet nga Komisioni për licencim (i përbërë nga 3 anëtarë), dhe vendimi për lëshimin e licencës aprovohet/refuzohet nga KKRF me shumicë votash (i përbërë prej 7 anëtarë). Afati për shqyrtim të kërkesës dhe procedura

e ankesës në vendim nuk janë të përcaktuara me këtë U.A., dhe në këtë rast zbatohen dispozitat e LPPA. Tarifa për licencim është 2500 euro, sipas Vendimit të KKRF-së për taksa administrative, pika 8, Dt. 03 Maj 2013 dhe tarifa për aplikim është 30 euro, Vendimi i KKRF-së për taksa administrative, pika 1, Dt. 03 Maj 2013 (i publikuar në webfaqe) dhe këtu ka hapësirë për thjeshtësim duke llogaritur këto tarifa në bazë të parimit të shpenzimit të procedurës administrative. Licenca lëshohet e nënshkruar nga Kryesuesi i KKRF-së për afat kohor të pacaktuar.

#### Licencimi i vlerësuesve të pronave të paluajtshme (Shkalla I)

Përmes kësaj procedure mundësohet licencimi i vlerësuesve të pronave të paluajtshme të Shkallës I (kjo shkallë mundëson vlerësimin e pronave deri në vlerën maksimale prej 300,000 euro). Kjo licencë ipet vetëm pasi aplikuesi të ketë kryer trajnimin kualifikues mbi fushën e vlerësimit të pronave të paluajtshme dhe të ketë kaluar me sukses provimet e aprovuara nga Këshilli Mbikëqyrës për Vlerësues të Pronave të Paluajtshme. Për t'u pajisur me këtë licencë, aplikuesit dorezojnë kërkesën për licencim së bashku me dokumentet plotësuese në mënyrë elektronike (online) tek Këshilli Mbikëqyrës për Licencimin e Vlerësuesve të Pronave të Paluajtshme (këtu e tutje "KMLVPP"). Dokumentet duhet të jenë të nënshkruara dhe skanuara dhe përfshijnë kërkesën me shkrim në formë biografie, kopje të diplomës universitare (të noterizuar ose vërtetuar, leternjoftimin (kopje e njehësuar me origjinalin), dëshmi për kualifikimi në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, dëshmi të vijimit të orëve të obligueshme të trajnimit, kalimin me sukses të provimit për vlerësimin e pronave të paluajtshme dhe deklaratën e etikes. Kërkesa e dokumenteve origjinale paraqet barrë shtesë për palën dhe në këtë rast ka hapësirë për thjeshtësim Kërkesa pranohet nga sekretariati i KMLVPP, i cili bën shqyrtimin e dokumentacionit dhe e percjell lenden për miratim tek KMLVPP. Ligji Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 17 përcakton Këshillin Mbikëqyrës për Licencimin e Vlerësuesve të Pronave të Paluajtshme si autoritetin kompetent për zbatimin e procedurës së vlerësimit dhe licencimit por nuk i përcakton qartë llojet e licencës apo procesin e rilicencimit. Afati për shqyrtim të kërkesës dhe procedura e ankeseës në vendim nuk janë të përcaktuara dhe në këtë rast zbatohen dispozitat e LPPA. Vlefshmëria e kësaj licencë është 1 vit që paraqet hapësirë për thjeshtësim. Kur lëshimi i këtyre licencave ka qenë kompetencë e OEK-së, licencimi ka kushtuar 700 euro dhe pagesa për aplikim 25 euro. Për shkak se MPFT dhe KMLVPP e konsiderojnë Rregulloren Nr. 06 e Bordit Mbikëqyrës për Procedurat dhe Kriteret e Licencimit të Personave Fizik si Vlerësues të Pronave të Paluajtshme (2013) të si të shfuqizuar, ndërsa draft-rregullorja të cilën e ka hartuar KMLVPP ende nuk është miratuar, vendimet për tarifa mirren aty për aty gjatë takimeve të KMLVPP (ndonëse nuk ka pasë asnjë aplikim për licencim për herë të parë që nga 2019). Në këtë rast ka hapësirë për thjeshtësim, në kuptimin që vendosja e tarifave me Rregulloren e re të llogaritet sipas parimit të shpenzimit të procedurës administrative nga organi kompetent. Licenca lëshohet e nënshkruar nga Kryesuesi i KMLVPP. Lëshimi i kësaj licence në afat prej 2 viteve nuk është praktikë e mirë dhe këtu ka hapësirë për thjeshtësim në mënyrë që vlefshmëria e licencës të jetë pa afat.

#### Licencimi i vlerësuesve të pronave të paluajtshme (Shkalla IA)

Përmes kësaj procedure mundësohet licencimi i vlerësuesve të pronave të paluajtshme të Shkalles IA; kjo shkallë ju është dhënë vlerësuesve të licencuar në shkallën I, të cilët duhet të kishin së paku 10 vlerësime për klientë me pagesë apo për institucionin (në rastet e të punësuarve në institucione si vlerësues) gjatë periudhës jo më pak se një (1) viti dhe jo në periudhë më të gjatë se dy (2) vite pas të licencimit për shkallën I. Kjo licencë ipet vetëm pasi aplikuesi të ketë kryer trajnimin kualifikues mbi fushën e vlerësimit të pronave të paluajtshme dhe të ketë kaluar me sukses provimet e aprovuara nga Keshilli Mbikëqyrës për Vlerësues të Pronave të Paluajtshme. Për t'u pajisur me këtë licencë, aplikuesit dorëzojnë kërkesën për licencim së bashku me dokumentet plotësuese në mënyrë elektronike (online). Dokumentet duhet të jenë të nënshkruara dhe skanuara dhe përfshijnë kërkesën me shkrim në formë biografie, kopje të diplomës universitare (të noterizuar ose vërtetuar), leternjoftimin (kopje e njehësuar me origjinalin), dëshmi për kualifikimin në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, dëshmi të vijimit të orëve të obligueshme të trajnimit, kalimin me sukses të provimit për vlerësimin e pronave të paluajtshme dhe deklaratën e etikes. Kërkesa e dokumenteve origjinale paraqet barrë shtesë për palën dhe në këtë rast ka hapësirë për thjeshtësim. Kërkesa pranohet nga sekretariati i KMLVPP, i cili bën shqyrtimin e dokumentacionit dhe e përcjell lënden për miratim tek KMLVPP. Ligji Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 17 përcakton Këshillin Mbikëqyrës për Licencimin e Vlerësuesve të Pronave të Paluajtshme si autoritetin kompetent për zbatimin e procedurës së vlerësimit dhe licencimit por nuk përcakton qartë llojin e licencës apo procesin e rilicencimit. Kur lëshimi i këtyre licencave ka qenë komptencë e OEK-së, licencimi ka kushtuar 700 euro dhe pagesa për aplikim 25 euro. Për shkak se KMLVPP e konsideron Rregulloren 06 të shfuqizuar, ndërsa draft-rregullorja e re është dërguar për interpretim ligjor dhe ende nuk është miratuar, vendimet për tarifa mirren aty për aty gjatë takimeve të KMLVPP (ndonëse nuk ka pasë asnjë aplikim për licencim për herë të parë që nga 2019). Në këtë rast ka hapësirë për thjeshtësim, në kuptimin që vendosja e tarifave me Rregulloren e re të llogaritet sipas parimit të shpenzimit të procedurës administrative nga organi kompetent. Licenca lëshohet e nënshkruar nga Kryesuesi i KMLVPP. Lëshimi i kësaj licence në afat prej 2 viteve nuk është praktikë e mirë dhe këtu ka hapësirë për thjeshtësim në mënyrë që vlefshmëria e licencës të jetë pa afat

#### Licencimi i vlerësuesve të pronave të paluajtshme (Shkalla IAB)

Përmes kësaj procedure mundësohet licencimi i vlerësuesve të pronave të paluajtshme të Shkalles IAB. Vlerësuesi duhet të kryej kursin e aprovuar nga Bordi prej së paku 40 orëve mbi vlerësimin e pasurive biznesore dhe personale me një pjesëmarrje së paku 90% të orëve, të kaloi me sukses provimin e aprovuar nga Bordi për vlerësimin e pronave biznesore dhe personale, të kryej minimum 5 vlerësime të bizneseve brenda një periudhe 2 vjecare dhe këto vlerësime të dorëzohen në Sekretariatit të Bordit. Dokumentet e kërkuara përfshijnë kërkesën me shkrim në formë biografie, kopje të diplomës universitare (të noterizuar ose vërtetuar), leternjoftimin (kopje e njehësuar me origjinalin), dëshmi për kualifikimin në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, dëshmi të vijimit të orëve të obligueshme të trajnimit, kalimin me sukses të provimit për vlerësimin e pronave të paluajtshme dhe deklaratën e etikes. Kërkesa e dokumenteve origjinale paraqet barrë shtesë për palën dhe në këtë rast ka hapësirë për thjeshtësim. Vendimin për dhënien e Licencës së Shkalles IAB e merr Bordi pas shqyrtimit të të dhënave të siguruara. Ligji Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme neni 17 përcakton Këshillin Mbikëqyrës për

Licencimin e Vlerësuesve të Pronave të Paluajtshme si autoritetin kompetent për zbatimin e procedurës së vlerësimit dhe licencimit por nuk përcakton qartë llojin e licencës apo procesin e rilicencimit. Bazë për këtë licencë deri së fundmi ka shërbyer Rregullorja Nr. 06 e Bordit Mbikqyrës për Procedurat dhe Kriteret e Licencimit të Personave Fizik si Vlerësues të Pronave të Paluajtshme (2013) të cilën Bordi e konsideron të shfuqizuar, ndërsa draft-rregullorja të cilën e ka hartuar KMLVPP ende nuk është miratuar, pasi që është dërguar për interpretim ligjor. Për shkak të shfuqizimit të Rregullores vendimet për tarifa mirren aty për aty gjatë takimeve të Këshillit (ndonese nuk ka pasë asnjë aplikim për licencim për herë të parë që nga 2019), Në këtë rast ka hapësirë për thjeshtësim, në kuptimin që vendosja e tarifave me Rregulloren e re të bëhet sipas parimit të shpenzimit të procedurës administrative nga organi kompetent. Licenca lëshohet e nënshkruar nga Kryesuesi i KMLVPP. Lëshimi i kësaj licence në afat prej 2 viteve nuk është praktikë e mirë dhe këtu ka hapësirë për thjeshtësim në mënyrë që vlefshmëria e licencës të jetë pa afat

#### Leje pune afatshkurtër për të huajt (deri në 90 ditë pune)

Përmes kësaj procedure mundësohet lëshimi i lejes afatshkurtër të punës për shtetas të huaj. Leja lëshohet në afat kohor prej 30, 60, apo 90 ditësh brenda cdo periudhe prej 180 ditëve brenda një viti. Në bazë të lejes (apo vërtetimit për lajmërimin e punës) deri në 90 ditë brenda 1 viti, mund të punojnë të huajt në profesionet e cekura në nenin 76 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt deri në 60 ditë brenda 1 viti mund të punojnë të huajt në profesionet e cekura në nenin 76 paragrafi 3 si dhe deri në 30 ditë mund të punojnë të huajt në profesionet e cekura në nenin 76 paragrafi 4. Për t'u pajisur me leje pune në afat kohor më të gjatë se 90 ditë, shtetasit e huaj duhet të drejtohen tek Ministrinë e Punëve të Brendshme për pajisje me leje qëndrimi për qëllim punësimi. Fillimisht punëdhënesi duhet të paraqesë kërkesën për leje të përkohshme të punës duke dorëzuar kërkesën e plotësuar si dhe dokumentacionin e nevojshëm që përfshinë kontratën e punës, sipas legjislacionit të punës në Republikën e Kosovës, dëshminë që nuk është nën hetime, e lëshuar nga organi kompetent i shtetit, shtetas i të cilit është i huaji apo nga shteti i vendbanimit të fundit, e përkthyer në njërën nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, certifikatën e regjistrimit të biznesit dhe informata mbi biznesin, dëshminë mbi arsimimin ose kualifikimin e fituar profesional, origjinali ose kopje e vërtetuar nga noteri dhe e përkthyer në njërën nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës tek zyrtarët administrativ në Agjencinë e Punësimin e Republikës së Kosovës (këtu "APRK"), të cilët bëjnë shqyrtimin e dokumentacionit dhe kompletimin e lëndës. Më pas kërkesa shqyrtohet nga Udhëheqesi i Divizionit të Shërbimeve të Migracionit në Departamentin e Tregut të Punës në APRK, cili merr vendimin për aprovimin apo refuzimin e lejes. Leja lëshohet e nënshkruar nga Udhëheqësi i Divizionit. Afati për shqyrtimin e kërkesës është 30 ditë, sipas U.A. neni 23 paragrafi 5 në baze të formularit që gjendet në Shtojcën 3 - Kërkesa për vërtetim për lajmërim të punës të U.A. Tarifa për këtë leje është si në vijim: 30 euro (për 30 ditë), 60 euro (për 60 ditë), dhe 90 euro (për 90 ditë pune) me vendim të ministrit. Ankesa në vendim mund të bëhet brenda tetë (8) ditëve nga pranimi i vendimit, për të cilën vendos Komisioni i Ankesave sipas Ligji Nr. 04/L-219 për të Huajt, neni 74 paragrafi 1. Vazhdimi i lejes bëhet në bazë të kriterëve të njëjta.

### Regjistrimi i ofruesve jo-publik të shërbimeve të punësimit (Kategoria A, B, dhe C)

Përmes kësaj procedure mundësohet regjistrimi i ofruesve jo-publik të shërbimeve të punësimit të kategorisë A, B, dhe C me c'rast lejohet edhe ushtrimi i veprimtarisë së tyre. Ofruesit e shërbimeve në kategorinë A ofrojnë shërbime që lidhen me kërkim të punës si ofrimi i informacioneve; ata në kategorinë B ofrojnë shërbime të ndërmjetësimit në mes të ofertave dhe aplikacioneve për punësim; ata në kategorinë C ofrojnë shërbime të rekurtimit përfshirë shërbimet këshilluese për punëdhënësit dhe punëkërkuuesit. Aplikuesit paraqesin kërkesën për regjistrimin fillimisht duke dorëzuar aplikacionin e plotësuar (Shtojca 1 e Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 03/2015 për Licencimin e Ofruesve Jo-Publik të Shërbimeve të Punësimit) si dhe dokumentacionin e nevojshëm për të deshmuar regjistrimin në Ministrinë e Tregtisë dhe kodin perkates, regjistrimin si organizate jo-qeveritare, tek sekretariati i komisionit për shqyrtim të aplikacionit (në Departamentin e Punës), i cili bën shqyrtimin e dokumentacionit dhe kompletimin e lëndes. Nuk është e qartë nëse këto dëshmi kërkohen të dorëzohen në kopje apo dokumente origjinale, prandaj këtu ka hapësire për thjeshtësim në mënyre që palëve t'u kërkohet dorëzimi i dëshmimeve vetëm si kopje. Më pas lënda shqyrtohet nga Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve (i përbërë nga 3 anëtarë), i cili merr vendimin për aprovimin apo refuzimin e regjistrimit. Kërkesa dorëzohet në bazë të Shtojcës 1 në U.A. (MPMS) Nr. 03/2015 dhe afati për shqyrtimin e kërkesës është 30 ditë, sipas Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 03/2015 për licencim e ofruesve jo-publik të shërbimeve të punësimit, neni 10 paragrafi 1. Tarifa për aplikim është 20 euro, sipas Udhëzimit Administrativ (MPMS) NR. 03/2015 për licencim e ofruesve jo-publik të shërbimeve të punësimit, neni 7. Kjo tarifë duhet të verifikohet nëse është llogaritur në pajtim me parimin e shenzimit të procedurës administrative të organit kompetent, dhe nëse jo, duhet të ri-llogaritet dhe vendoset në bazë të këtij parimi. Procedurat e ankesës nuk parashihen me U.A.dhe në mungesë zbatohen dispozitat relevante sipas LPPA.

### Leje për ofrues jo-publik të shërbimeve të punësimit (Kategoria D dhe E)

Përmes kësaj procedure mundësohet lëshimi i lejes për ofrues jo-publik të shërbimeve të punësimit të kategorisë D dhe E me c'rast lejohet edhe ushtrimi i veprimtarisë së tyre. Ofruesit e shërbimeve të kategorisë D ofrojnë shërbime të përbëra nga punësimi i punëtorve me synimin për t'i bërë ato në dispozicion të një palë të tretë, që mund të jetë person fizik apo juridik; ndërsa ofruesit e shërbimeve në kategorinë E ofrojnë shërbime të ndërmjetësimit jashtë vendit. Aplikuesit paraqesin kërkesën për licencim fillimisht duke dorëzuar aplikacionin e plotësuar si dhe dokumentacionin e nevojshëm tek sekretariati i komisionit për shqyrtim të aplikacionit (në Departamentin e Punës), i cili bën shqyrtimin e dokumentacionit dhe kompletimin e lëndes. Në kuader të dokumentacionit për marrjen e kësaj leje kërkohen në mes tjerash dëshmia e regjistrimit në Ministrinë e Tregtisë dhe kodi I aktivitetit ekonomik, dëshmia e regjistrimit si organizate jo-qeveritare, kontratën e punës me punonjësit, kopjet e diplomave të punonjësve, vertetimi që nuk ka obligime tatimore dhe certifikata e numrit fiskal. Këtu ka hapësire për thjeshtësim në mënyre që palëve t'u kërkohet dorëzimi i dëshmimeve vetëm si kopje. Më pas lënda shqyrtohet nga Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve (i përbërë nga 3 anëtarë), i cili merr vendimin për aprovimin apo refuzimin e lejes. Leja lëshohet e nënshkruar nga Ministri me afat kohor prej 1 viti, pas së cilës periudhë pala duhet të aplikojë për vazhdimin e saj (vazhdimi bëhet

me afat deri ne 3 vjet).. Tarifa për aplikim është 20 euro, sipas Udhezimi Administrativ (MPMS) Nr. 03/2015 për licencim e ofruesve jo-publik të shërbimeve të punesimit, neni 7. Kjo tarifë duhet të verifikohet nëse është llogaritur në pajtim me parimin e shenzimit të procedurës administrative të organit kompetent, dhe nëse jo, duhet te ri-llogaritet dhe vendoset në bazë të këtij parimi. Ankesa shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave në afat prej 30 ditësh sipas U.A Nr. 03/2015 neni 11. Lëshimi i kësaj leje në afat prej 1 viti nuk është praktikë e mirë dhe këtu ka hapësirë për thjeshtësim në mënyrë që vlefshmëria e licencës të jetë pa afat

#### Licencimi i organizatave joqeveritare dhe subjekteve tjera juridike private që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare

Përmes kësaj procedure mundësohet licencimi i organizatave joqeveritare dhe subjekteve tjera juridike private që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare. Aplikuesit paraqesin kërkesen për licencim fillimisht duke dorëzuar aplikacionin e plotësuar si dhe dokumentacionin e nevojshem tek Departamenti I Politikave Sociale dhe Familjare (këtu e tutje “DPSF”), ku zyrtaret pergjegjes bejne shqyrtimin e dokumentacionit dhe kompletimin e lendes. Ne kuader te dokumentacionit, ne mes tjerash, kerkohen certifikata e regjistrimit, statuti I personit juridik, kopjet e licencave te ofrueseve individual, certificate nga organi kompetent qe subjekti ofrues nuk eshte ne shuarje, dhe falimentim – original ose kopje e noterizuar, certificate pronesie apo marreveshje qirare per zyre (kopje e noterizuar), dhe certifikatë pronësie apo marrëveshje qiraje për zyre (kopje e noterizuar) me të cilen deshmohet posedimi I hapësirave të mjaftueshme. Këtu ka hapësirë për thjeshtësim në mënyrë që për dokumentet të cilat kërkohen në original ose kopje të noterizuar, palëve t’u kërkohen vetëm kopje. Më pas lenda shqyrtohet nga Komisioni për licencim (i përbërë nga 5 anëtarë), i cili merr vendimin per aprovimin apo refuzimin e lejes. Leja lëshohet e nenshkruar nga Drejtori i DPSF dhe Ministri/a e MFPT në afat kohor prej 1 viti, pas së ciles periudhë pala duhet te aplikojë për ri-licencim (lëshohet licenca ne afat prej 3 vitesh), dhe me pas pala aplikon për ri-licencim për licencë në afat kohor prej 5 vitesh. Sipas Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 02/2020 për Licencimin e Organizatave Jo Qeveritare dhe Subjekteve Juridike Private që Ofrojnë Shërbime Sociale dhe Familjare afati për shqyrtimin e kërkeses është 30 ditë ndërsa tarifa 30 euro sipas Vendimit nr. 497 të dates 23/12/2014. Ankesa në vendim mund të dorëzohet brenda 30 ditëve sipas U.A. Neni 20.

#### Licencimi i ofrueseve individual te shërbimeve sociale dhe familjare

Përmes kësaj procedure mundësohet licencimi i ofrueseve individual të shërbimeve sociale dhe familjare. Aplikuesit paraqesin kërkesen për licencim fillimisht duke dorëzuar aplikacionin e plotësuar si dhe dokumentacionin e nevojshem tek DPSF, ku zyrtaret përgjegjes bëjne shqyrtimin e dokumentacionit dhe kompletimin e lëndës. Në kuadër të dokumentacionit, në mes tjerash, kërkohen certifikata e regjistrimit, statuti i personit juridik, kopjet e licencave të ofrueseve individual, certifikatë nga organi kompetent që subjekti ofrues nuk është në shuarje dhe falimentim – original ose kopje e noterizuar, certifikatë pronësie apo marreveshje qiraje për zyre (kopje e noterizuar), dhe certifikatë pronësie apo marreveshje qiraje për zyre (kopje e noterizuar) me të cilen dëshmohet posedimi i hapësirave te mjaftueshme. Këtu ka hapësirë për thjeshtësim në mënyrë që për dokumentet të cilat kërkohen në original ose kopje te noterizuar, palëve t’u

kërkohen vetëm kopje. Me pas lënda shqyrtohet nga Komisioni për licencim (i përbërë nga 5 anetarë), i cili merr vendimin për aprovimin apo refuzimin e licences. Licenca lëshohet e nënshkruar nga Kryetari/ja i/e KPSHSF dhe Ministri/ja i/e MFPT. Licenca lëshohet në afat kohor prej 1 viti, pas së ciles periudhe pala duhet të aplikojë për rilicencim (lëshohet licenca në afat prej 3 vitesh), dhe me pas pala aplikon për ri-licencim për licence në afat kohor prej 5 vitesh dhe këtu ka hapësirë për thjeshtësim duke mundësuar dhënien e kësaj licence pa afat. Afati për shqyrtimin e kërkeses është 30 ditë sipas Administrativ (MPMS) Nr. 02/2020 për Licencimin e Organizatave Jo Qeveritare dhe Subjekteve Juridike Private që Ofrojnë Shërbime Sociale dhe Familjare, Neni 9, ndërsa tarifa 5 euro sipas Vendimit 01/13 i datës 28/01/2013. Ankesa në vendim mund të dorëzohet brenda 30 ditëve sipas U.A. Neni 20, ndërsa vlefshmeria e licences është 1 vit, me mundësi ri-licencimi për 3 vite dhe më pas 5 vite sipas U.A. Nr. 02/2020, neni 23. Lëshimi i licencës në afat prej 1 viti nuk paraqet praktikë të mirë dhe për këtë arsye është e nevojshme që të mundësohet dhënia pa afat e kësaj licence.

#### Licencimi i personave juridik për ofrimin e shërbimeve për sigurinë dhe shëndetin në punë (Licenca e shërbimit)

Përmes kësaj procedure mundësohet licencimi i personave juridik për ofrimin e shërbimeve për sigurinë dhe shëndetin në punë (Licenca e shërbimit). Fillimisht pala dorëzon kërkesën dhe dokumentacionin e kompletuar tek Sekretariati i Komisionit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Në kuader të dokumentacionit për marrjen e licences, në mes tjerash, kërkohen Lista e ekspertëve të punësuar për sigurinë dhe shëndetin në punë, duke përfshirë emrat, mbiemrat, numrat e letërnjoftimit të tyre, numri i Certifikatave të Ekspertëve, periudha e validitetit të Certifikatave të Ekspertëve, Lista e shërbimeve të ofruara, konfirmimi i vërtetësisë së informacionit dhe nënshkrimin e personit përgjegjës juridik, kopjet e regjistrimit të biznesit, Kopjen e letërnjoftimit të personit përgjegjës juridik, kopje të Certifikatave të Ekspertëve, korniza organizative dhe procedura të shkruara pune për të gjitha shërbimet që ofrohen për të punësuarit, p.sh. vlerësimi i riskut në vendin e punës, sistemi i menaxhimit të sigurisë, planifikimi emergjent etj, dëshmia e mundësisë për të siguruar matjet teknike të faktorëve të riskut në vendin e punës etj.

Më pas Komisioni shqyrton lënden dhe merr vendimin për refuzim apo aprovim të licences. Licenca lëshohet e nënshkruar nga Ministri në afat kohor të pakufizuar. Afati për shqyrtimin e kërkeses është 45 ditë, sipas Rregullores, Neni 18, paragrafi 1, ndërsa tarifa licencimin e personave juridik për ofrimin e shërbimeve për sigurinë dhe shëndetin në punë, 200 euro, sipas Rregullores (MPMS) Nr. 01/2021 për Kualifikimin e Personave Përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Licencimin e Kompanive të Shërbimeve dhe Trajnimeve për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, neni 20. Vlefshmëria e licences është e pa afatizuar, sipas Rregullores, neni 19 paragrafi 5, ndërsa procedurat e ankesës në mungesë të dispozites përkatëse në Rregullore, zhvillohen në bazë të LPPA.

#### Licencimi i gendrave të trajnimit për sigurinë dhe shëndetin në punë



Përmes kësaj procedure mundësohet licencimi i qendrave të trajnimit për sigurinë dhe shëndetin në punë (Licenca e shërbimit). Fillimisht pala dorëzon kërkesen dhe dokumentacionin e kompletuar tek Sekretariati i Komisionit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Në kuadër të dokumentacionit, në mes tjerash, kërkohet edhe lista e trajnerëve të punësuar për sigurinë dhe shëndetin në punë, duke përfshirë emrat, mbiemrat, numrat e letërnjoftimit të tyre, numri e Certifikatave të Trajnerëve, periudhën e validitetit të Certifikatave të Trajnerëve; lista e trajnimeve të ofruara, kopjet e regjistrimit të biznesit, kopja e letërnjoftimit të personit përgjegjës juridik, kopje të Certifikatave të Trajnerëve, Programet e aprovuara për trajnime të planifikuara për realizim, Dëshminë e mundësisë për të siguruar matjet teknike të faktorëve të riskut në vendin e punës etj.

Më pas Komisioni shqyrton lëndën dhe merr vendimin për refuzim apo aprovim të licences. Rregullorja (Mpms) Nr. 01/2021 për Kualifikimin e Personave Përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Licencimin e Kompanive të Shërbimeve dhe Trajnimeve për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Afati për shqyrtimin e kërkeses është 45 ditë, sipas Rregullores 01/2021, Neni 30 paragrafi 1, ndërsa tarifa për licencimin e qendrave të trajnimit, 200 euro, sipas Rregullores (MPMS) Nr. 01/2021, neni 32. Licenca lëshohet pa afat sipas Rregullores, neni 31 paragrafi 5, ndërsa procedurat e ankeses, në mungesë të dispozites përkatëse në Rregullore, zhvillohen në bazë të LPPA. Licenca lëshohet e nënshkruar nga Ministri.

#### 4.1. Rekomandime të përgjithshme

Sipas analizës së lejimeve të administruara nga MFPT janë identifikuar të gjeturat kryesore në bazë të të cilave janë nxjerrë rekomandimet e përgjithshme si në vijim:

- Lejet dhe licencat të parashihen me anë të ligjeve.
- Lejet dhe licencat të jepen pa afat përderisa verifikimi i plotësimit të kushteve ligjore mund të bëhet përmes rregullave të pezullimit dhe revokimit të përcaktuara në LSL
- Pagesat dhe taksat administrative si rregull të mos zbatohen por edhe kur parashikohen të mos kalojnë shumën e nevojshme për të mbuluar shpenzimet e organit publik për të administruar lejimin.
- Të përditësohet Regjistri për të përfshirë lejimet që mungojnë dhe për të hequr ato që nuk konsiderohen lejime.
- Në përgjithësi ka kërkesa për aplikim të cilat janë të panevojshme por edhe të papërshtatshme të sigurohen p.sh. kopje origjinale apo të noterizuara të dokumentacionit.

## 4.2. Rekomandimet e veçanta

Pjesë e këtij raporti është edhe analiza që identifikon secilin lejm të analizuar, emrin dhe llojin e lejimit, autoritetin përgjegjës, të gjeturat, si dhe rekomandimet e veçanta për thjeshtim. Kjo analizë është paraqitur në Shtojcën I në vijim.

## Shtojca 1 – Rekomandimet e veçanta

Institucio ni	Nr.ref	Emri lejimit	Lloji lejimit	Autoriteti përgjegjës	Të gjeturat	Rekomandimet
MFPT	MFPT-1	Licenca per banderolla për prodhuesit e pijeve alkoolike	Licencë	Sektori i Procedurave Doganore dhe Autorizimeve të Doganës së Kosovës (Dogana e Kosovës), MFPT	<p>1. Sipas LSSL licenca ipet për personat fizik dhe jo për personat juridik dhe në këtë rast emërtimin si licencim nuk është adekuat.</p> <p>2. Nuk është e qartë nëse në disa prej kërkesave për dokumentacion kërkohet dokument origjinal apo vetëm kopje.</p> <p>3. Vlefshmëria e licencës është e afatizuar.</p>	<p>1. Të ndryshohet/plotësohet Kodi Nr. 03/L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë, Neni 242 paragrafi 1, Udhëzim Administrativ 86/2010 që përcakton obligimin e vendosjes se shenjave kontrolluese fiskale banderolavene pijet alkoolike, neni 1 paragrafi 1 dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 44/2017 per ndryshimin dhe plotesimin e UA Nr. 86/2010 qe percakton obligimin e vendosjes se shenjave kontrolluese fiskale ne pijet alkoolike, Neni 3, Neni 5A, Neni 5B ku përmendet “licenca” të zëvendësohet me “leje.”</p> <p>2. Të ndryshohet/plotësohet Udhëzimi Administrativ Nr. 44/2017 per ndryshimin dhe plotesimin e UA Nr. 86/2010 qe percakton obligimin e vendosjes se shenjave kontrolluese fiskale ne pijet alkoolike, neni 5B për të përcaktuar se kërkohen vetëm kopje të kontrata me prodhuesit ose kompanine eksportuese, licencen nga MBPZHR per import te vererave, certifikaten e konformitetit.</p>

MFPT	MFPT-2	Licenca për banderolla për importuesit e pijeve alkoolike	Licencë	Sektori i Procedurave Doganore dhe Autorizimeve të Doganës së Kosovës (Dogana e Kosovës), MFPT	1. Sipas LSSL licenca ipet për personat fizik dhe jo për personat juridik dhe në këtë rast emërtimin si licencim nuk është adekuat.	1. Të ndryshohet/plotësohet Kodi Nr. 03/L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë, Neni 242 paragrafi 1, Udhëzim Administrativ 86/2010 që përcakton obligimin e vendosjes se shenjave kontrolluese fiskale banderolave në pijet alkoolike, neni 1 paragrafi 1 dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 44/2017 për ndryshimin dhe plotësimin e UA Nr. 86/2010 që përcakton obligimin e vendosjes së shenjave kontrolluese fiskale në pijet alkoolike, Neni 3, Neni 5A, Neni 5B ku përmendet “licenca” të zëvendësohet me “leje.”
MFPT	MFPT -3	Licenca për pagesën e taksës së akcizës për produkte te duhanit (apo Licencim (autorizim) për furnizim me banderola fiskale për produktet e duhanit)	Licencë	Sektori i Procedurave Doganore dhe Autorizimeve të Doganës së Kosovës (Dogana e Kosovës), Ministria e Financave	1. Sipas LSSL licenca ipet për personat fizik dhe jo për personat juridik dhe në këtë rast emërtimin si licencim nuk është adekuat. 2. Disa prej kërkesave për dokumentacion kërkohet të jenë dokumente origjinal apo të vertetuara. 3. Vlefshmëria e licencës është 1 vit. 4. Tarifa nuk duket që është llogaritur në bazë të shpenzimit të procedurës administrative të	1. Të ndryshohet/plotësohet Udhëzimi Administrativ Nr. 4/2012 për lëshimin e licencës për pagesën e taksës se akcizes dhe shumës se taksës administrative ku përmendet “licenca” të zëvendësohet me “leje.” 2. Të ndryshohet/plotësohet Udhëzimi Administrativ Nr. 4/2012 për lëshimin e licencës për pagesën e taksës se akcizes dhe shumës se taksës administrative, neni 3-5 për të përcaktuar se kërkohen vetëm kopje certifikata e regjistrimit te biznesit, certifikata e tatimpaguesit -TVSH, certifikata e numrit fiscal, kontrata me prodhuesin per furnizim me cigare dhe të eliminohet mundësia që Dogana ta ketë në

					<p>organit kompetent për të administruar këtë lejim.</p>	<p>diskrecion që të kërkoj edhe dokumente shtesë pa e specifikuar cilat janë ato.</p> <p>3. Të ndryshohet/plotësohet Udhëzimi Administrativ Nr. 4/2012 për lëshimin e licencës për pagesën e takses se akcizes dhe shumës se takses administrative, neni 3-5 që të mundësohet dhënia e licencës në afat prej 2 vitesh.</p> <p>4. Të ndryshohet dhe plotësohet Udhëzimi Administrativ Nr. 4/2012 për lëshimin e licencës për pagesën e takses se akcizes dhe shumës se takses administrative, neni 6 që tarifa prej 100 euro të llogaritet dhe përcaktohet në bazë të parimit të shpenzimit të procedurës së organit publik.</p>
MFPT	MFPT-4	Licencimi i auditoreve ligjore vendore	Licencë	Keshilli Kosovar për Raportim Financiar (KKRF), Ministria e Financave	<p>1. Disa prej kërkesave për dokumentacion kërkohej të jenë dokumente origjinal apo të noterizuara.</p> <p>2. Tarifa nuk duket që është llogaritur në bazë të shpenzimit të procedurës administrative të organit kompetent për të administruar këtë lejim.</p> <p>3. Vlefshmëria e licencës është 1 vit.</p>	<p>1. Të ndryshohet/plotësohet Formulari dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2019 (MFPT) për licencimin e auditorëve ligjorë dhe firmave vendore e të huaja ligjore të auditimit, për të mundësuar dorëzimin e vetëm kopjeve për certifikata e biznesit, certifikata e nr. fiskal, certifikata e auditorit nga Shoqata Profesionale, dëshmi e anëtarisë në Shoqatën Profesionale, dëshmi – Vertetim për përvojë tre (3) vjeçare në auditim me orar të plotë lëshuar, dëshmi – vertetim për punë në mbikqyrje të auditorit</p>

					<p>ligjor, letër referencë, formulari për caktimin e punëdhësit për lajmërim në ATK ose pasqyrat vjetore nga TRUSTI, Kpolica e sigurimit, letër angazhime ose kontrata për bashkëauditim në subjekte të auditimit.</p> <p>2. Të ndryshohet/plotësohet Vendimi te KKRF-së për taksa administrative, pika 1 dhe 2, I dates 03 Maj 2013 qe tarifa prej 30 eurove per aplikim dhe tafirfa prej 300 euro per licencim te llogariten dhe përcaktohen në bazë të parimit të shpenzimit të procedures së organit publik.</p> <p>3. Të ndryshohet/plotësohet Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2019 (MFPT) per licencimin e auditorive ligjore dhe firmave vendore e te huaja ligjore te auditimit, neni 6 që të mundësohet dhënia e licencës me afat të vlefshmërisë prej 3 vitesh.</p>
MFPT	MFPT-5	Licencimi i auditorëve ligjor të huaj	Licencë	<p>Keshilli Kosovar per Raportim Financiar (KKRF), Ministria e Financave</p>	<p>1. Disa prej kërkesave për dokumentacion kërkohet të jenë dokumente origjinal apo të noterizuara.</p> <p>2. Tarifa nuk duket që është llogaritur në bazë të shpenzimit të procedurës administrative të</p> <p>1. Të ndryshohet/plotësohet Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2019 (MFPT) per licencimin e auditorive ligjore dhe firmave vendore e te huaja ligjore te auditimitqë dhe Formulari per te mundesuar dorezimin e vetem kopjeve per certifikata e biznesit, certifikata e nr.fiskal, certifikata e auditorit nga Shoqata Profesionale, dëshmi e anëtarise në Shoqaten Profesioanle, dëshmi –Vertetim për përvojë tre (3)vjeçare në</p>

					<p>organit kompetent për të administruar këtë lejim.</p> <p>3. Vlefshmëria e licencës është 1 vit.</p>	<p>auditim me orar të plotë lëshuar, dëshmi – vertetim për punë nënë mbikqyrje të auditorit ligjor, letër referencë, formulari për caktimin e punëdhësit për lajmërim në ATK ose pasqyrat vjetore nga TRUSTI, polica e sigurimit, letër angazhime ose kontrata për bashkëauditim në subjekte të auditimit.</p> <p>2. Të ndryshohet/plotësohet Vendimi të KKRF-së për taksa administrative, pika 1 dhe 3, i datës 03 Maj 2013 që tarifa prej 30 eurove për aplikim dhe tatarifa prej 750 euro për licencim të llogariten dhe përcaktohen në bazë të parimit të shpenzimit të procedurës së organit publik.</p> <p>3. Të ndryshohet/plotësohet Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2019 (MFPT) për licencimin e auditorëve ligjor dhe firmave vendore e të huaja ligjore të auditimit që të mundësohet dhënia e licencës me afat të vlefshmërisë prej 3 vitesh.</p>
MFPT	MFPT-6	Licencimi i firmave ligjore vendore (ndërmarrje vendore e auditimit)	Licence	Keshilli Kosovar për Raportim Financiar (KKRF), MF	<p>1. Sipas LSSL licenca i për personat fizik dhe jo për personat juridik dhe në këtë rast emërtimin si licencim nuk është adekuat.</p> <p>2. Disa prej kërkesave për dokumentacion kërkohet të jenë</p>	<p>1. Të ndryshohet/plotësohet Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2019 (MFPT) për licencimin e auditorëve ligjore dhe firmave vendore e të huaja ligjore të auditimit ku përmendet “licenca” të zëvendësohet me “leje.”</p> <p>2. Të ndryshohet/plotësohet Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2019 (MFPT) për licencimin</p>

					<p>dokumente original apo të noterizuara.</p> <p>3. Tarifa nuk duket që është llogaritur në bazë të shpenzimit të procedurës administrative të organit kompetent për të administruar këtë lejim.</p> <p>4. Vlefshmëria e licencës është 1 vit.</p>	<p>e auditorive ligjore dhe firmave vendore e të huaja ligjore të auditimit dhe Formulari për të mundësuar dorëzimin e vetëm kopjeve për certifikaten e biznesit, certifikaten e Nr.fiskal, deshmi për anëtarinë e auditorëve në Shoqatën Profesionale.</p> <p>3. Të ndryshohet/plotësohet Vendimi të KKRF-së për taksa administrative, pika 1 dhe 4, I dates 03 Maj 2013 që tarifa prej 30 eurove për aplikim dhe tatarifa prej 1500 euro për licencim të llogariten dhe përcaktohen në bazë të parimit të shpenzimit të procedurës së organit publik.</p> <p>4. Të ndryshohet/plotësohet Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2019 (MFPT) për licencimin e auditorëve ligjoredhe firmave vendore e të huaja ligjore të auditimit që të mundësohet dhënia e licencës me afat të vlefshmërisë prej 3 vitesh.</p>
MFPT	MFPT-7	Licencimi i firmave ligjore të huaja (ndërmarrje auditore e huaj/jashtme)	Licencë	Keshilli Kosovar për Raportim Financiar (KKRF), MF	<p>1. Sipas LSSL licenca ipet për personat fizik dhe jo për personat juridik dhe në këtë rast emërtimin si licencim nuk është adekuat.</p> <p>2. Disa prej kërkesave për dokumentacion kërkohet të jenë</p>	<p>1. Të ndryshohet/plotësohet Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2019 (MFPT) për licencimin e auditorive ligjore dhe firmave vendore e të huaja ligjore të auditimit ku përmendet “licenca” të zëvendësohet me “leje.”</p> <p>2. Të ndryshohet/plotësohet Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2019 (MFPT) për licencimin e auditorive ligjore dhe firmave vendore e të</p>



					<p>dokumente origjinal apo të noterizuara.</p> <p>3. Tarifa nuk duket që është llogaritur në bazë të shpenzimit të procedurës administrative të organit kompetent për të administruar këtë lejim.</p> <p>4. Vlefshmëria e licencës është 1 vit.</p>	<p>huaja ligjore te auditimit dhe Formulari (linku) per te mundesuar dorezimin e vetem kopjeve per certifikata e nr.fiskal, licencë profesioni nga organizata anëtare e IFAC-FNK, marrëveshja për njohje reciproke mes organizatës që e ka lëshuar licencen dhe FNK-IFAC, dëshmi për dhënjen e provimeve për ligjet komerciale, të punës dhe tatimeve të Republikës së Kosovës në Shoqatë Profesionale, dëshmi e anëtarisë në Shoqatën Profesionale, letër referencë nga tre (3) auditor të jashtëm si dëshmi për standardet e larta të kompetencës dhe integritetit profesional të aplikuesit, deklarata me shkrim nga aplikuesi se nuk është denuar ndonjëher për mashtrim ose parregullësi financiare në vendin ku e ka marrë certifikatën –licencën për ushtrimin e profesionit, policen e sigurimit, dëshmi se është banor rezident në Kosovë.</p> <p>3. Të ndryshohet/plotësohet Vendimi të KKRF-së për taksa administrative, pika 1 dhe 4, I datës 03 Maj 2013 që tarifa prej 30 eurove për aplikim dhe taksat prej 3000 euro për licencim të llogariten dhe përcaktohen në bazë të parimit të shpenzimit të procedurës së organit publik.</p> <p>4. Të ndryshohet/plotësohet Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2019 (MFPT) për licencimin e auditorëve ligjorë dhe firmave vendore e të</p>
--	--	--	--	--	---	---

						huaja ligjore te auditimit që të mundësohet dhënia e licencës me afat të vlefshmërisë prej 3 vitesh.
MFPT	MFPT-8	Licencimi i shoqatave profesionale të kontabilitetit dhe auditimit	Licencë	Keshilli Kosovar për Raportim Financiar (KKRF), MF	<p>1. Sipas LSSL licenca ipet për personat fizik dhe jo për personat juridik dhe në këtë rast emërtimin si licencim nuk është adekuat.</p> <p>2. Tarifa nuk duket që është llogaritur në bazë të shpenzimit të procedurës administrative të organit kompetent për të administruar këtë lejim.</p> <p>3. Nuk është e përcaktuar qartë në U.A. nese dokumentacioni kerkohet të dorëzohet në original apo kopje dhe në këtë rast ka hapësirë për shtjeshtësim duke mundësuar dorëzimin e ketyre dokumenteve në kopje.</p>	<p>1. Të ndryshohet/plotësohet Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2019 (MFPT) per licencimin e auditorive ligjore dhe firmave vendore e te huaja ligjore te auditimit ku përmendet “licenca” të zëvendësohet me “leje.”</p> <p>2.Të ndryshohet/plotësohet Vendimi te KKRF-së për taksa administrative, pika 1 dhe 8, i datës 03 Maj 2013 që tarifa prej 30 euro për aplikim dhe tafirfa prej 3000 euro për licencim të llogariten dhe përcaktohen në bazë të parimit të shpenzimit të procedurës së organit publik.</p> <p>3. Të ndryshohet/plotësohet Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2019 (MFPT) per licencimin e auditorive ligjore dhe firmave vendore e te huaja ligjore te auditimit per te mundesuar qe statuti, strategjia dhe plani I biznesit, burimet financiare, deshmia qe te jete organizate joqeveritare sipas Ligjit per Lirine e Asociimit ne Organizatat Jo Qeveretiare të dorëzohen vetëm si kopje.</p>

MFPT	MFPT-9	Licencimi i vlerësuesve të pronave të paluajtshme (Shkalla I)	Licencë	Keshilli Mbikqyrës për Licencimin e Vlerësuesve të Pronave të Paluajtshme (KMLVPP), Ministria e Financave	<p>1. Ligji Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme neni 17 përcakton Këshilli Mbikëqyrës për Licencimin e Vlerësuesve të Pronave të Paluajtshme si autoritetin kompetent për zbatimin e procedurës së vlerësimit dhe licencimit por nuk përcakton qartë llojin e licences apo procesin e rilicencimit.</p> <p>2. Bazë për këtë licencë deri se fundmi ka shërbyer Rregullorja Nr. 06 e Bordit Mbikqyrës për Procedurat dhe Kriteret e Licencimit të Personave Fizik si Vlerësues të Pronave të Paluajtshme (2013) te cilën MFPT e konsideron të shfuqizuar, me arsyetimin se draft-rregullorja të cilën e ka hartuar Këshilli është në procedurë miratimi.</p> <p>3. Vleshfshmeria e licencës është 1 vit.</p> <p>4. Kur lëshimi i kësaj licence ka qenë kompetencë e Odes Ekonomike të Kosovës, licencimi ka kushtuar 700</p>	<p>1. Te ndryshohet/plotësohet Ligji Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 17 për të përcaktuar qartë këtë lloj të licencës.</p> <p>2. Të ndryshohet/plotësohet Rregullorja Nr. 06 e Bordit Mbikqyrës për Procedurat dhe Kriteret e Licencimit të Personave Fizik si Vlerësues të Pronave të Paluajtshme (2013) apo te miratohet Rregullorja e re dhe për këtë lloj të licencës që të përcaktohet procedura dhe kriteret e aplikimit, sipas përcaktimeve të rekomanduara në piken 1 më lartë.</p> <p>3. Të ndryshohet/plotësohet Rregullorja Nr. 06 e Bordit Mbikqyrës për Procedurat dhe Kriteret e Licencimit të Personave Fizik si Vlerësues të Pronave të Paluajtshme (2013), neni 18 apo te miratohet Rregullorja e re dhe të mundësohet dhënia e licencës me afat 5 vjeçar.</p> <p>4. Të ndryshohet/plotësohet Rregullorja Nr. 06 e Bordit Mbikqyrës për Procedurat dhe Kriteret e Licencimit të Personave Fizik si Vlerësues të Pronave të Paluajtshme (2013) apo te miratohet Rregullorja e re dhe tarifa për licencim të llogaritet dhe përcaktohet në bazë të parimit të shpenzimit të procedurës së organit publik.</p> <p>5. Të shfuqizohet Vendimi Nr. 02/2021 për caktimin e tarifave për vazhdimin e licencave për</p>
------	--------	---	---------	---	--	--

					<p>euro dhe pagesa për aplikim 25 euro. Në bazë të informatave nga MFPT meqenëse sipas tyre Rregullorja Nr. 06 e Bordit Mbikqyrës për Procedurat dhe Kriteret e Licencimit të Personave Fizik si Vlerësues të Pronave të Paluajtshme (2013) është e shfuqizuar, vendimet për tarifa mirren Keshilli (ndonëse nuk ka pasë asnjë aplikim për licencim për herë të parë që nga 2019).</p> <p>5. Tarifa per aplikim per ri-licencim eshte 50 euro sipas Vendimi Nr. 02/2021 per caktimin e tarifave per vazhdimin e licencave per VPP, pika 1 nenpika 1.</p> <p>6. Disa nga kërkesat për dokumentacion me rastin e aplikimit të ndjekjes së trajnimit për t'u licencuar si vlerësues, kërkohet të jenë noterizuara ose origjinale.</p>	<p>VPP, pika 1 nenpika 1 dhe tarifa per licencim te llogaritet dhe përcaktohet në bazë të parimit të shpenzimit të procedures së organit publik.</p> <p>6. Te ndryshohet/plotësohet Rregullorja Nr. 06 e Bordit Mbikqyrës për Procedurat dhe Kriteret e Licencimit të Personave Fizik si Vlerësues të Pronave të Paluajtshme (2013), neni 21 për të mundësuar që dokumentet që përfshijnë kërkesen me shkrim në formë biografie, kopje të diplomës universitare (të noterizuar ose vërtetuar, leternjoftimin (kopje e njehësuar me origjinalin), dëshmi për kualifikimi në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, dëshmi të vijimit të orëve të obligueshme të trajnimit, kalimin me sukses të provimit për vlerësimin e pronave të paluajtshme dhe deklaratën e etikes të mund të dorëzohen si kopje.</p>
MFPT	MFPT-10	Licencimi i vlerësuesve të pronave të	Licencë	Keshilli Mbikqyrës për Licencimin e	<p>1.Ligji Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 17 percakton Këshilli Mbikëqyrës për Licencimin e Vlerësuesve të</p>	<p>1. Të ndryshohet/plotësohet Ligji Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 17 për të përcaktuar qartë këtë lloj të licences.</p>

		<p>paluajtshme (Shkalla IA)</p>		<p>Vlerësuesve të Pronave të Paluajtshme (KMLVPP), Ministria e Financave</p>	<p>Pronave të Paluajtshme si autoritetin kompetent për zbatimin e procedurës së vlerësimit dhe licencimit por nuk i përcakton qarte llojin e licences apo procesin e rilicencimit.</p> <p>2. Bazë për këtë licencë deri se fundmi ka shërbyer Rregullorja Nr. 06 e Bordit Mbikqyrës për Procedurat dhe Kriteret e Licencimit të Personave Fizik si Vlerësues të Pronave të Paluajtshme (2013) te cilën MFPT e konsideron të shfuqizuar, me arsyetimin se draft-rregullorja të cilën e ka hartuar Këshilli është në procedurë miratimi.</p> <p>3. Vleshfshmëria e licences është 1 vit.</p> <p>4. Kur lëshimi i kësaj licence ka qenë kompetencë e Odes Ekonomike të Kosovës, licencimi ka kushtuar 700 euro dhe pagesa për aplikim 25 euro. Në bazë të informatave nga MFPT meqenëse sipas tyre Rregullorja Nr. 06 e Bordit</p>	<p>2. Të ndryshohet/plotësohet Rregullorja Nr. 06 e Bordit Mbikqyrës për Procedurat dhe Kriteret e Licencimit të Personave Fizik si Vlerësues të Pronave të Paluajtshme (2013) apo te miratohet Rregullorja e re dhe për këtë lloj të licencës të përcaktohet procedura dhe kriteret e aplikimit, sipas përcaktimeve të rekomanduara në pikën 1 më lartë.</p> <p>3. Të ndryshohet/plotësohet Rregullorja Nr. 06 e Bordit Mbikqyrës për Procedurat dhe Kriteret e Licencimit të Personave Fizik si Vlerësues të Pronave të Paluajtshme (2013), neni 18 apo te miratohet Rregullorja e re dhe të mundësohet dhënia e licencës me afat 5 vjeçar.</p> <p>4. Të ndryshohet/plotësohet Rregullorja Nr. 06 e Bordit Mbikqyrës për Procedurat dhe Kriteret e Licencimit të Personave Fizik si Vlerësues të Pronave të Paluajtshme (2013) apo te miratohet Rregullorja e re dhe tarifa për licencim të llogaritet dhe përcaktohet në bazë të parimit të shpenzimit të procedurës së organit publik.</p>
--	--	---------------------------------	--	--	---	--

					Mbikqyrës për Procedurat dhe Kriteret e Licencimit të Personave Fizik si Vlerësues të Pronave të Paluajtshme (2013) është e shfuqizuar vendimet për tarifa mirren nga Keshilli (ndonëse nuk ka pasë asnjë aplikim për licencim për herë të parë që nga 2019).	
MFPT	MFPT-11	Licencimi i vlerësuesve të pronave të paluajtshme (Shkalla IAB)	Licencë	Keshilli Mbikqyrës për Licencimin e Vlerësuesve të Pronave të Paluajtshme (KMLVPP), Ministria e Financave	<p>1. Ligji Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 17 përcakton Këshilli Mbikëqyrës për Licencimin e Vlerësuesve të Pronave të Paluajtshme si autoritetin kompetent për zbatimin e procedurës së vlerësimit dhe licencimit por nuk i përcakton qartë llojin e licences apo procesin e rilicencimit.</p> <p>2. Bazë për këtë licencë deri se fundmi ka shërbyer Rregullorja Nr. 06 e Bordit Mbikqyrës për Procedurat dhe Kriteret e Licencimit të Personave Fizik si Vlerësues të Pronave të Paluajtshme (2013) te cilën MFPT e konsideron të shfuqizuar, me arsyetimin se draft-rregullorja të</p>	<p>1. Të ndryshohet/plotësohet Ligji Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 17 për te përcaktuar qarte kete lloj te licences.</p> <p>2. Të ndryshohet/plotësohet Rregullorja Nr. 06 e Bordit Mbikqyrës për Procedurat dhe Kriteret e Licencimit të Personave Fizik si Vlerësues të Pronave të Paluajtshme (2013) apo te miratohet Rregullorja e re dhe për këtë lloj të licencës të përcaktohet procedura dhe kriteret e aplikimit, sipas përcaktimeve të rekomanduara në pikën 1 më lartë.</p> <p>3. Të ndryshohet/plotësohet Rregullorja Nr. 06 e Bordit Mbikqyrës për Procedurat dhe Kriteret e Licencimit të Personave Fizik si Vlerësues të Pronave të Paluajtshme (2013), neni 18 apo te miratohet Rregullorja e re dhe të mundësohet dhënia e licences me afat 5 vjeçar.</p>

				<p>cilën e ka hartuar Këshilli është në procedurë miratimi.</p> <p>3. Vleshshmëria e licences është 2 vite.</p> <p>4. Kur lëshimi i kësaj licence ka qenë kompetencë e Odes Ekonomike të Kosovës, licencimi ka kushtuar 700 euro dhe pagesa për aplikim 25 euro. Në bazë të informatave nga MFPT meqenëse sipas tyre Rregullorja Nr. 06 e Bordit Mbikqyrës për Procedurat dhe Kriteret e Licencimit të Personave Fizik si Vlerësues të Pronave të Paluajtshme (2013) është e shfuqizuar vendimet për tarifa mirren aty për aty gjatë takimeve të Keshillit (ndonëse nuk ka pasë asnjë aplikim për licencim për herë të parë që nga 2019).</p> <p>5. Tarifa për aplikim për vazhdim të licences është 50 euro sipas Vendimi Nr. 02/2021 për caktimin e tarifave për vazhdimin e licencave për VPP, pika 1 nënpika 1.</p>	<p>4. Të ndryshohet/plotësohet Rregullorja Nr. 06 e Bordit Mbikqyrës për Procedurat dhe Kriteret e Licencimit të Personave Fizik si Vlerësues të Pronave të Paluajtshme (2013) apo të miratohet Rregullorja e re dhe tarifa për licencim të llogaritet dhe përcaktohet në bazë të parimit të shpenzimit të procedurës së organit publik.</p> <p>5. Të shfuqizohet Vendimi Nr. 02/2021 për caktimin e tarifave për vazhdimin e licencave për VPP, pika 1 nënpika 1.</p>
--	--	--	--	---	--

MFPT	MFPT-12	Leje pune afatshkurter per te huajt (deri ne 90 dite pune)	Leje	Agjencia e Punesimit e Republikes se Kosoves	<p>1. Tarifa për këtë leje është si në vijim: 30 euro (për 30 ditë), 60 euro (për 60 ditë), dhe 90 euro (për 90 ditë pune).</p> <p>2. Nuk është e qartë nëse në kuadër të kërkesave për dokumentacion, dokumenti i vlefshëm të udhëtimit, kontrata e punës dhe certifikata e regjistrimit të biznesit, kërkohen të dorëzohen si dokumente origjinale apo vetëm kopje.</p>	<p>1. Të verifikohet nëse tarifat janë të llogaritura sipas parimit të shpenzimit të procedurës administrative të organit publik dhe sipas nevojës të ndryshohet/plotësohet Vendimi i Ministrit duke i llogaritur këto tarifa në bazë të këtij parimi.</p> <p>2. Të ndryshohet/plotësohet Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr. 09/2019 për Procedurën dhe Kriteret e Lëshimit të Lejes së Qëndrimit për të Huajt, Neni 10 për të mundësuar që dokumenti i vlefshëm i udhëtimit, kontrata e punës, dhe certifikata e regjistrimit të biznesit të dorëzohen vetëm si kopje.</p>
MFPT	MFPT-13	Regjistrimi i ofruesve jo-publik të shërbimeve të punësimit (Kategoria A, B, dhe C)	Regjistrimi	Departamenti i Punës, MFPT	<p>1. Tarifa për aplikim është 20 euro.</p> <p>2. Nuk është e qartë nëse në kuadër të kërkesave për dokumentacion, certifikata e numrit fiskal kërkohet si dokument origjinal apo vetëm kopje.</p>	<p>1. Të verifikohet nëse tarifa është llogaritur sipas parimit të shpenzimit të procedurës administrative të organit publik dhe sipas nevojës të ndryshohet/plotësohet Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr. 03/2015 për licencimin e ofruesve jo-publik të shërbimeve të punësimit, neni 7.</p> <p>2. Të ndryshohet/plotësohet Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr. 03/2015 për licencimin e ofruesve jo-publik të shërbimeve të punësimit, Shtojca 1, për të mundësuar që certifikata e numrit fiskal të dorëzohet vetëm si kopje.</p>



MFPT	MFPT-14	Leje per ofrues jo-publik te sherbimeve te punesimit (Kategoria D dhe E)	Leje	Departament i i Punes, MFPT	<p>1.Tarifa për aplikim për këtë leje është 20 euro.</p> <p>2.Tarifa për aplikim për vazhdimin e lejes është 10 euro.</p> <p>3.Nuk është e qartë nëse në kuadër të kërkesave për dokumentacion, certifikata e numrit fiskal kërkohet si dokument origjinal apo vetëm kopje.</p> <p>4. Leja lëshohet në afat prej 1 viti.</p>	<p>1.Të verifikohet nëse tarifa është llogaritur sipas parimit të shpenzimit të procedurës administrative të organit publik dhe sipas nevojës të ndryshohet/plotësohet Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr. 03/2015 për licencimin e ofruesve jo-publik të shërbimeve të punësimit, neni 7.</p> <p>2.Të ndryshohet/plotësohet Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr. 03/2015 për licencimin e ofruesve jo-publik të shërbimeve të punësimit, neni 7 për të eliminuar tarifen.</p> <p>3.Të ndryshohet/plotësohet Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr. 03/2015 për licencimin e ofruesve jo-publik të shërbimeve të punësimit, Shtojca 2, për të mundësuar që certifikata e numrit fiskal të dorëzohet vetëm si kopje.</p> <p>4.Të ndryshohet/plotësohet Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr. 03/2015 për licencimin e ofruesve jo-publik të shërbimeve të punësimit për të mundësuar që kjo leje të ipet me afat të vlefshmërisë prej 3 vitesh.</p>
MFPT	MFPT-15	Licencimi i organizatave joqeveritare dhe subjekteve	Licencë	Departament i i Politikave Sociale dhe i	<p>1. Sipas LSSL licenca ipet për personat fizik dhe jo për personat juridik dhe në këtë rast emërtimi si licencim nuk është adekuat.</p>	<p>1. Të ndryshohet/plotësohet Udhëzimi Administrativ (MMPS) Nr. 02/2020 për Licencimin e Organizatave Jo Qeveritare dhe Subjekteve Juridike Private që Ofrojnë Shërbime</p>

		tjera juridike private që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare		Familjes, MFPT	<p>2.Tarifa për aplikim për këtë licencim është 30 euro.</p> <p>3.Tarifa për aplikim për ri-licencim është 30 euro.</p> <p>4. Leja leshohet ne afat prej 1 viti.</p> <p>5. Disa nga dokumentet për aplikim kërkohet të dorëzohen në original apo kopje të noterizuara.</p>	<p>Sociale dhe Familjare ku përmendet “licenca” të zëvendësohet me “leje.”</p> <p>2.Të verifikohet nëse tarifa është llogaritur sipas parimit të shpenzimit të procedurës administrative të organit publik dhe sipas nevojës të ndryshohet/plotësohet Vendimi nr. 497 të datës 23/12/2014.</p> <p>3.Të ndryshohet/plotësohet Vendimi nr. 497 i datës 23/12/2014 për të mundësuar eliminimin e kësaj tarife.</p> <p>4.Të ndryshohet/plotësohet Udhëzimi Administrativ (MMPS) Nr. 02/2020 për Licencimin e Organizatave Jo Qeveritare dhe Subjekteve Juridike Private që Ofrojnë Shërbime Sociale dhe Familjare, neni 20 për të mundësuar që kjo leje të ipet me afat të vlefshmërisë prej 3 vitesh.</p> <p>5. Të ndryshohet/plotësohet Udhëzimi Administrativ (MMPS) Nr. 02/2020 për Licencimin e Organizatave Jo Qeveritare dhe Subjekteve Juridike Private që Ofrojnë Shërbime Sociale dhe Familjare ne menyre qe certifikata e regjistrimit, statuti I personit juridik, kopjet e licencave te ofrueseve individual, certificate nga organi kompetent qe subjekti ofrues nuk eshte ne shuarje, dhe falimentim – original ose kopje e</p>
--	--	--	--	----------------	--	--

						noterizuar, certifikate pronësie apo marreveshje qirare për zyrë (kopje e noterizuar, dhe certifikate pronësie apo marreveshje qirare për zyrë (kopje e noterizuar) me të cilën dëshmohet posedimi i hapësirave të mjaftueshme. Këtu ka hapësirë për thjeshtësim në mënyrë që për dokumentet të cilat kërkohen në origjinal ose kopje të noterizuar, palëve t'u kërkohen vetëm kopje.
MFPT	MFPT-16	Licencimi i ofruesëve individual të shërbimeve sociale dhe familjare	Licencë	Departamenti i Politikave Sociale dhe i Familjes, MFPT	<p>1.Tarifa për licencim është 5 euro.</p> <p>2.Tarifa për ri-licencim është 5 euro.</p> <p>3.Vlefshmeria e licencës është 1 vit (nëse bëhet ripërtëritja për herë të parë), ndërsa 5 vite nëse bëhet ripërtëritja për herë të dytë apo më shumë.</p>	<p>1.Të verifikohet nëse tarifa është llogaritur sipas parimit të shpenzimit të procedurës administrative të organit publik dhe sipas nevojës të ndryshohet/plotësohet Vendimit 01/13 i datës 28/01/2013.</p> <p>2.Të ndryshohet/plotësohet Vendimit 01/13 i datës 28/01/2013 për të mundësuar eliminimin e tarifës.</p> <p>3.Të ndryshohet/plotësohet Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr. 02/2020 për Licencimin e Organizatave Jo Qeveritare dhe Subjekteve Juridike Private që Ofrojnë Shërbime Sociale dhe Familjare, neni 23 për të mundësuar që kjo leje të ipet me afat të zgjatur prej 2 vitesh herën e parë, ndërsa 5 vite për herën e dytë e tutje.</p>

MFPT	MFPT-17	Licencimi i personave juridik per ofrimin e shërbimeve për sigurinë dhe shëndetin në punë (Licenca e shërbimit)	Licencë	Divizioni për Marrëdhënie pune, dialog social, sigurinë dhe shëndetin në punë, MFPT	<p>1. Sipas LSSL licenca ipet për personat fizik dhe jo për personat juridik dhe në këtë rast emërtimin si licencim nuk është adekuat.</p> <p>2.Tarifa e licencimit të personave juridik për ofrimin e shërbimeve për sigurinë dhe shëndetin në punë është 200 euro.</p>	<p>1. Të ndryshohet/plotësohet Ligji Nr. 04/I-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, neni 9 paragrafi 5 dhe Rregullorja (Mpms) Nr.01/2021 për Kualifikimin e Personave Përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Licencimin e Kompanive të Shërbimeve dhe Trajnimeve për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë ku përmendet “licenca” të zëvendësohet me “leje.”</p> <p>2.Të verifikohet nëse tarifa është llogaritur sipas parimit të shpenzimit të procedurës administrative të oganit publik dhe sipas nevojës të ndryshohet/plotësohet Rregullorja (Mpms) Nr.01/2021 për Kualifikimin e Personave Përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Licencimin e Kompanive të Shërbimeve dhe Trajnimeve për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, neni 20.</p>
MFPT	MFPT-18	Licencimi i qendrave të trajnimit për sigurinë dhe shëndetin në punë	Licencë	Divizioni për Marrëdhënie pune, dialog social, sigurinë dhe shëndetin në punë, MFPT	<p>1. Sipas LSSL licenca ipet për personat fizik dhe jo për personat juridik dhe në këtë rast emërtimin si licencim nuk është adekuat.</p> <p>2.Tarifa e licencimit të qendrave të trajnimit për sigurinë dhe shëndetin në punë është 200 euro.</p>	<p>1. Të ndryshohet/plotësohet Të ndryshohet/plotësohet Ligji Nr. 04/I-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, neni 9 paragrafi 5 dhe Rregullorja (Mpms) Nr.01/2021 për Kualifikimin e Personave Përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Licencimin e Kompanive të Shërbimeve dhe Trajnimeve për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë ku përmendet “licenca” të zëvendësohet me “leje.”</p>

						2.Të verifikohet nëse tarifa është llogaritur sipas parimit të shpenzimit të procedurës administrative të oganit publik dhe sipas nevojës të ndryshohet/plotësohet Rregullorja (Mpms) Nr. 01/2021 për Kualifikimin e Personave Përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Licencimin e Kompanive të Shërbimeve dhe Trajnimeve për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, neni 32.
--	--	--	--	--	--	--